



Seri Dokumentesh Politike

# Shqipëria drejt EUROPA 2020



• SFIDAT E ARSIMIT TË LARTË

• POLITIKAT E PUNËSIMIT DHE TË ARSIMIT E FORMIMIT PROFESIONAL

• KËRKIMI SHKENCOR DHE INOVACIONI

**Botues**  
Konrad - Adenauer - Stiftung e.V  
Zyra e Tiranës

**Tiranë 2014**

Ky botim është mundësuar nga Fondacioni Konrad Adenauer, zyra e Tiranës në bashkëpunim me Qendrën për Kërkim dhe Zhvillim pranë IDM

**Fondacioni Konrad Adenauer (KAS)** është një fondacion politik pranë Unionit Kristian-Demokrat të Gjermanisë, i cili punon në partneritet me institucionet shtetërore, me partitë, me organizatat e shoqërisë civile si dhe me elita të përzgjedhura. Nëpërmjet qëllimeve dhe idealeve të përbashkëta KAS dëshiron që veçanërisht në politikën e zhvillimit, të thellohet në të ardhmen bashkëpunimi politik rajonal e global.

Fondacioni „Konrad Adenauer“ - Zyra për Shqipërinë, vë në jetë projekte për të arritur përbushjen e kushteve të anëtarësimit të Shqipërisë në BE në të gjithë sektorët, siç janë: ekonomia, politika, ai social dhe në atë të sistemit juridik e të administratës shtetërore.

**Qendra për Kërkim dhe Zhvillim** pranë IDM synon të nxisë dhe promovojë kërkimin shkencor për politikë-bërje të bazuar në evidenca si dhe për një zhvillim social, ekonomik dhe kulturor në vend dhe më gjerë. Qendra mbledh në grupe pune ekspertë dhe akademikë nga vendi, rajoni e më gjerë, sipas fushave dhe prioriteteve të projekteve të përbashkëta kërkimore. Qendra përfshihet në shqyrtimin dhe mbështetjen e zhvillimit të shoqërisë civile në vend dhe në sinergji me akademinë dhe aktorë të tjerë nxit dhe përmirëson kërkimin shkencor për një qeverisje të hapur dhe zhvillim të qëndrueshëm.

# Përmbajtja

Parathënie.....	5
Sfidat e arsimit të lartë në Shqipëri në kuadër të prioriteteve të strategjisë 'EUROPA 2020'.....	7
Politikat e punësimit dhe të arsimit e formimit profesional.....	23
Kërkimi Shkencor dhe Inovacioni: Adresimi i sfidave dhe rolit të munguar të sektorit privat.....	41



## PARATHËNIE

Në qershor 2010, Bashkimi Evropian prezantoi Strategjinë e re për punë dhe rritje të zgjuar, të qëndrueshme dhe gjithë-përfshirëse - EUROPA 2020. Përgatitjet e Ballkanit Perëndimor për anëtarësim në të ardhmen, sugjerojnë se qëllimet e politikave të brendshme dhe metodat e zbatimit të EUROPA 2020 janë me vend për vendet e zgjerimit, ndaj Komisioni i BE i bën thirrje këtyre vendeve të adaptojnë EUROPA 2020 për të udhëhequr zhvillimin e tyre socio-ekonomik.

Shqipëria po ecën ngadalë por me siguri në rrugën e saj drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Marrja e statusit kandidat, solli më pranë vëmendjes të politikë-bërësve rëndësinë dhe sfidën e ndërmarrjes së reformave për një zhvillim të qëndrueshëm. Nxitja e zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm, rritja e punësimit, përfshirja sociale, mbrojtja e mjedisit etj, janë disa nga çështjet "e nxehta" në diskursin politik kombëtar. Në kontekstin e ndërvarësisë globale dhe në një marrëdhënie të ngushtë me Bashkimin Evropian, Shqipëria duhet të mendojë dhe veprojë strategjikisht për të kontekstualizuar veprimet e saj.

Ndërkohë që reformat kryesore dhe strategjitë sektoriale në kuadër të Shqipëria 2014-2020, janë duke u finalizuar, politika konkrete në fusha specifike (psh: punësimi, përfshirja sociale, mjedisi, arsimi, inovacioni etj), duhet të hartohen dhe adaptohen. Në këtë linjë, objektivat e Strategjisë EUROPA 2020, qëndrojnë si një kornizë referencë për të orientuar politikat konkrete që do sjellin një rritje të qëndrueshme dhe të zgjuar edhe në Shqipëri.

Seria e dokumenteve politike "Shqipëria drejt EUROPA 2020!

Le të flasim për këtë çështje" është produkt i një procesi të gjerë konsultimesh, i cili paraqet rekomandime konkrete për rritjen e koherencës së politikave shqiptare në linjë me objektivat e BE 2020, në 3 fusha kryesore: **Punësimi / Arsimi dhe Formimi Profesional, Arsimi i Lartë dhe Kërkimi Shkencor dhe Inovacioni.**

Strategjia EUROPA 2020 paraqet një platformë nga e cila Shqipëria mund të "mësojë" në termat e vendosjes së axhendës dhe të objektivave të politikave. Dokumentet e Politikave prezantojnë aspektet kyç të Strategjisë EUROPA 2020 në fushat e mësipërme dhe pasi analizohen implikimet për Shqipërinë, ekspertët japin një set rekomandimesh se si politikat kombëtare duhet të hartohen në të njëjtën frymë me objektivat e BE. Ky botim synon të nxisë debatin publik mbi politikat konkrete në këto fusha si dhe të prezantojë politikë-bërësit me një set rekomandimesh për hartimin e politikave për një rritje të qëndrueshme dhe të mirë-orientuar kah Bashkimin Evropian.



# SFIDAT E ARSIMIT TË LARTË NË SHQIPËRI NË KUADËR TË PRIORITETEVE TË STRATEGJISË 'EUROPA 2020'

Autorë: Prof. Asoc. Dr. Nevila Xhindi, PhD. Dokt. Blerjana Bino, M.A. Egest Gjokutaj

## I. HYRJE

Arsimi i lartë, kërkimi shkencor dhe inovacioni janë elementë thelbësore të zhvillimit social dhe ekonomik të një vendi në kushtet e një ekonomie të bazuar kah dijes. Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim në Shqipëri (2008-2013) njezh këtë rol parësor të arsimit të lartë dhe synon reformimin e mëtejshëm të sistemit të arsimit të lartë për të qenë në përputhje me standardet europiane. Drafti i Strategjisë së re Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (2014-2020) rikonfirmon këtë rol të arsimit të lartë dhe përcakton si prioritetet cilësinë e arsimit të lartë; profilizimin e universiteteve sipas nevojave të zhvillimit të vendit dhe tregut të punës; rivlerësim i ndarjes së kostos së arsimit të lartë me studentët si dhe përmirësim i qeverisjes së brendshme të universiteteve duke kombinuar autonominë, përgjegjshmërinë me qeverisjen e mirë. Hapa përpara janë shënuar me miratimin e Ligjit për Arsimin e Lartë në Shqipëri në vitin 2007 dhe hartimin e Strategjisë Kombëtare të Arsimit të Lartë (2008-2013) në pajtueshmëri me Procesin e Bolonjës dhe me prioritetet e zhvillimit të arsimit të lartë në Bashkimin Europian. Së fundmi, procesi më i rëndësishëm në këtë kuadër është propozimi i reformës së re në arsimin e lartë<sup>1</sup> si dhe verifikimi i ligjshmërisë së veprimtarisë së institucioneve të arsimit të lartë që rezultoi me mbylljen e 18 IAL-ve dhe pezullimin e 13 të tjerave (VKM, Nr. 539). Ndërmarrja e këtyre proceseve lidhet ngushtë edhe me vlerësimin dhe hartimin e strategjive të reja për periudhën 2014-2020 të vendit, të cilat janë në linjë me strategjinë e rritjes së BE-së, EUROPA 2020. Prioritetet e EUROPA 2020 për rritjen ekonomike dhe veçanërisht për zhvillimin e arsimit të lartë, kërkimin shkencor dhe inovacionin janë të vlefshme edhe për Shqipërinë dhe vendet e tjera aspiruese për tu bërë pjesë e BE-së.

Qëllimi i këtij artikulli është që të parashtrojë disa rekomandime për sfidat e arsimit të lartë në Shqipëri nën dritën e strategjisë EUROPA 2020. Gjithashtu, ky artikull synon të kontribuojë në vazhdimin e debatit në sferën publike lidhur me reformimin e arsimit të lartë në Shqipëri në kuadër të procesit të integritimit në BE dhe të strategjisë EUROPA 2020. Për të realizuar këtë analizë, ky artikull bazohet tek një qasje metodologjike cilësore të përdorimit të burimeve dytësore dhe intervistave të thëlluara informuese me aktorë në sistemin e arsimit të lartë në Shqipëri. Seksioni i parë paraqet një analizë të pozicionimit të arsimit të lartë në kuadër të strategjisë EUROPA 2020 si dhe të Procesit të Bolonjës në Europë përmes shqyrtimit të burimeve dytësore si botime të Komisionit Europian, artikuj akademikë, raporte të Eurydice.

1.Raporti Final për Reformimin e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor pritet të miratohet nga Këshilli i Ministrave në fund të shtatorit 2014 dhe më pas të kalojë për diskutim në Parlament në fund të tetorit 2014.

Seksioni i dytë analizon sfidat e arsimit të lartë në Shqipëri duke u ndaluar në mënyrë të veçantë tek reformimi i vazhdueshëm i arsimit të lartë dhe Procesi i Bolonjës; dikotomia arsim privat vs. publik si dhe tek roli i ri i universiteteve në ekonominë e dijes. Burimet kryesore të përdorura janë dokumentat strategjikë të qeverisë shqiptare dhe Ministrisë së Arsimit e Sporteve, botime rreth arsimit të lartë në Shqipëri, artikuj si dhe intervista të thelluara informuese. Seksioni i fundit parashtron disa rekomandime për zhvillimin e mëtejshëm të arsimit të lartë në Shqipëri dhe reformimin e tij nën dritën e prioriteteve dhe instrumentave të strategjisë EUROPA 2020.

## **II. ARSIMI I LARTË NË BASHKIMIN EUROPIAN NË KUADËR TË STRATEGJISË EUROPA 2020**

### **2.1 Strategjia e rritjes EUROPA 2020 dhe arsimit i lartë**

EUROPA 2020 është strategjia e rritjes e Bashkimit European për dekadën në vazhdim, e lindur si një nevojë për të kapërcyer krizën financiare dhe ekonomike që ka rrokur prej 2008-s vëndet anëtare të BE-së. Në një kuptim më strategjik dhe afatgjatë, EUROPA 2020 ka për qëllim të adresojë mangelitë e modelit aktual të zhvillimit të BE-së dhe të krijojë kushtet për një model të ri rritjeje. Kështu EUROPA 2020 synon të sigurojë një rritje që është më: (i) cilësore (smart growth) përmes investimeve më efektive në arsim, kërkim dhe inovacion; (ii) e qëndrueshme përmes politikave të mbrojtjes mjedisore dhe një ekonomie me më pak emetim karboni; (iii) gjithëpërfshirëse përmes krijimit të mundësive për punësim dhe zbutjes së varfërisë. Strategjia EUROPA 2020 adreson veçanërisht pesë fusha kyçe: punësimi, inovacioni, arsimi, zbutja e varfërisë dhe klima/energji. Arritja e objektivave lidhet ngushtë jo vetëm me përpjekjet në nivelin e BE-së, por edhe me përkthimin e tyre në politika konkrete në vëndet anëtare si edhe në ato aspiruese për tu bërë pjesë e BE-së.

Një dimension i rëndësishëm i strategjisë së rritjes EUROPA 2020 është edhe arsimi i lartë, kërkimi dhe inovacioni. Në mënyrë që të arrihet një rritje më cilësore, e qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse EUROPA ka nevojë për më shumë të diplomuar të pajisur me njohuritë dhe aftësitë e duhura për tu përballur me sfidat e tregut të punës dhe të shoqërisë bashkëkohore. Së dyti, EUROPA ka nevojë për një përdorim më efektiv të potencialit për kërkim dhe inovacion që zotërojnë institucionet e arsimit të lartë si në kapacitete institucionale ashtu edhe në kapital njerëzor. Komisioni European ka përcaktuar një axhendë për modernizimin e sistemeve të arsimit të lartë në Europë, e cila parashtron edhe fushat kryesore për reforma (Komisioni European, 2011). Modernizimi i arsimit të lartë, zhvillimi i mëtejshëm i kërkimit dhe inovacionit shihen si dimensione që do të kontribuojnë në dimensionin social të Strategjisë EUROPA 2020 duke ulur nivelin e varfërisë dhe duke nxitur gjithëpërfshirjen. Megjithatë, Strategjia EUROPA 2020 është kritikuar për mungesë të përshtjellimit të detajuar të dimensionit social si dhe të një modeli zhvillimi social (Daly, 2012: 278). Pavarësisht, dimensionin social, si gjithëpërfshirja në arsim e grupeve të skajuar dhe mbështetja financiare për programet universitare, përbën gjithashtu një objektiv parësor për Hapësinë Europiane

të Arsimit të Lartë nisur nga parimet mbi të cilat mbështet EUROPA 2020. Strategjia EUROPA 2020 parashikon pesë prioritete të modernizimit të arsimit të lartë: (i) niveli i arsimit të lartë si zgjerimi i mundësive të hyrjes, i rrugëve të ndjekjes së arsimit të lartë, zvogëlimi i numrit të braktisjeve të studimeve; (ii) cilësia dhe rëndësia e arsimit të lartë duke u ndalur tek programet e studimit, metodat e mësimdhënies, kërkimit dhe përgatitja e stafit akademik; (iii) ndërkombëtarizimi i arsimit të lartë, bashkëpunimi dhe lëvizshmëria e stafit dhe studentëve; (iv) përforsimi i trekëndëshit të dijes përmes lidhjes së arsimit të lartë, me kërkimin dhe inovacionin; (v) qeverisja e institucioneve të arsimit të lartë, financimi dhe fondet për kërkim dhe zhvillim. Këto priorite do të realizohen përmes instrumentave të mëposhtëm:

### **Rritja e nivelit të arsimit të lartë:**

- Lehtësimi i rrugëve të progresit akademik si edhe njohja e kualifikimeve dhe eksperiencave të mëparshme;
- Rritja e mundësive të hyrjes në arsimin e lartë të grupeve të skajuar si dhe mbështetja financiare e targetuar;
- Ulja e nivelit të braktisjes së studimeve;
- Zgjerimi i pjesëmarrjes;
- Përfundimi i studimeve – diplomimi në kohë.

### **Përmirësimi i cilësisë dhe rëndësisë së arsimit të lartë:**

- Përshtatja e metodologjisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies sipas diversitetit të studentëve;
- Shfrytëzimi i potencialit të teknologjive të informacionit dhe komunikimit;
- Skema të motivimit dhe shpërblimit të stafit akademik në bazë të performancës së shkëlqyer;
- Programe studimi që bazohen në dhe i përshtaten kërkesave të tregut të punës;
- Sigurimi i cilësisë;
- Financimi bazuar në performancë;
- Lidhjet me biznesin;
- Punësimi i të diplomuarve.

---

## Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe lëvizshmëria:

- Krijimi i hapësirave të lëvizshmërisë për studentë dhe staf dhe mundësitë e transferimit midis programeve të studimit;
- Njohja e studimeve jashtë;
- Përmirësimi i mundësive të hyrjes në universitet dhe punësimit të studentëve dhe kërkuesve nga vendet jo anëtare të BE-së.

## Përforcimi i trekëndëshit të dijes: arsimit, kërkimi dhe inovacioni

- Zhvillimi i aftësive krijuese, inovatore dhe sipërmarrëse dhe për mirësimi i mjediseve të të nxënit;
- Zhvillim i partneriteteve midis universiteteve dhe biznesit;
- Përfshirja e institucioneve të arsimit të lartë në planet e zhvillimit rajonal.

## Krijimi i modelit të duhur të qeverisjes dhe financimit të institucioneve të arsimit të lartë:

- Financim eficient, i mjaftueshëm dhe me objektiva të mirëpërcaktuara;
- Fuqizimi i institucioneve të arsimit të lartë.

Sa i takon arsimit të lartë, Strategjia EUROPA 2020 reflekton në një farë mase edhe parimet e Procesit të Bolonjës, prioritetet e të cilit në vitin 2010 u riorientuan kah saj.

## 2.2 Procesi i Bolonjës drejt EUROPA 2020

Procesi i Bolonjës e ka transformuar arsimin e lartë në Europë. Përmes ndryshimeve strukturore të ndërmarra nga vendet nënshkruese të Kartës së Bolonjës, është bërë e mundur krijimi i Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë. Disa nga arritjet kryesore në këtë drejtim janë ndërtimi i kushteve që arsimit të lartë të jetë në gjendje t'i përgjigjet kërkesave të larta të shoqërisë bashkëkohore; modifikimi i strukturave të arsimit të lartë; zhvillimi i sistemeve të sigurimit të cilësisë; zhvillimi i instrumentave për të lehtësuar shkëmbimin dhe lëvizshmërinë në Hapësirën Europiane të Arsimit të Lartë; identifikimi dhe përforcimi i rolit të institucioneve të arsimit të lartë në zhvillimin social dhe ekonomik (Carter, 2010: 256). Nisur nga parimi i mësimin përgjatë gjithë jetës, Procesi i Bolonjës synon të nxisë konkurrueshmërinë globale, të zhvilloj punësimin individual dhe të përforcoj cilësinë dhe pozitën e formimit profesional evropian. Në mënyrë të veçantë për arsimin e lartë, lëvizshmëria e stafit akademik dhe studentëve si dhe hapja e fleksibiliteti i programeve të studimit janë përcaktuar si objektiva parësor

të procesit të Bolonjës (Powell, et.al., 2012: 245). Përmes tyre synohet përshtetimi i europianizimit të arsimit të lartë dhe ndërtimi i Hapësirës Europiane për Arsimin e Lartë.

Një dimension tjetër kyç i axhendës së Procesit të Bolonjës është edhe Arsimi dhe Formimi Profesional, qëllimet e të cilit orientohen më tepër nga punësimi dhe konkurrueshmëria. Formimi i aftësive profesionale, sipas traditës europiane, mbështet si në arsimin e lartë edhe në formimin profesional, por në mënyrë të pavarur nga njëri tjetri me qëllim krijimin e një force pune të aftë dhe të përshtatshme me kërkesat e tregut të punës. Përgjegjësia e financimit në arsimim dhe formim profesional është individuale, pasi modeli evropian përcakton punësimin si objektivin parësor të arsimit dhe formimit profesional. Megjithatë me Strategjinë 2020, dimensionin social del më në hap me theks tek gjithëpërfshirja sociale dhe mbështetja financiare për kryerjen e studimeve.

Në kuadër të Strategjisë EUROPA 2020, objektivat kryesore për Procesin e Bolonjës janë: (i) finalizimi i reformës strukturore and thellimi i zbatimit të saj përmes përdorimit të qendrueshëm të instrumentave të zhvilluar deri më tani në kuadër të këtij procesi; (ii) përmirësimi i cilësisë së arsimit të lartë, zhvillimi i kërkimit dhe nxitja e mësimi përgjatë gjithë jetës si dhe promovimi i punësimi; (iii) përforcimi i dimensionit social të arsimit të lartë në mënyrë të tillë që trupa e studentëve që hyjnë në universitet të reflektojnë diversitetin e shoqërive europiane; (iv) bashkëpunimi dhe lëvizshmëria ndërkombëtare, të paktën 20% e të diplomuarve në Hapësirën Europiane të Arsimit të Lartë duhet të kenë kryer një periudhë studimi apo kërkimore jashtë (Børslund, 2012).

### III. SFIDAT E ARSIMIT TË LARTË NË SHQIPËRI DREJT EUROPËS 2020

#### 3.1 Konteksti i arsimit të lartë: Procesi i Bolonjës dhe reformimi i vazhdueshëm

Në kushtet e ndryshimeve të gjithanshme të shoqërisë, ekonomisë dhe politikës, përgjatë procesit të demokratizimit dhe perspektivave të anëtarësimit në BE, arsimit të lartë në Shqipëri është në transformim dhe reformim të vazhdueshëm nga një sistem të kontrolluar nga shteti drejt një sistemi të liberalizuar të arsimit të lartë. Dy nga zhvillimet më të rëndësishme në këtë proces transformimi kanë qenë: (i) implementimi i Procesit të Bolonjës dhe përpjekjet për tu bërë pjesë e Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë dhe Hapësirës Europiane të Kërkimit; (ii) liberalizimi i arsimit të lartë dhe licensimi i universiteteve private si alternativë ndaj atyre shtetërore. Shqipëria u bë pjesë e Procesit të Bolonjës me nënshkrimin e Deklaratës së Bolonjës në vitin 2003. Më pas, në vitin 2007 u miratua Ligji për Arsimin e Lartë në Shqipëri, i cili reflektonte po të njëjtën frymë dhe rregullonte më tej sistemin e dyfishtë publik dhe privat të arsimit të lartë. Parimet dhe udhëzimet e Procesit të Bolonjës përbëjnë edhe kuadrin formues të Strategjisë Kombëtare për Arsimin e Lartë 2008-2013.

Pavarësisht përfshirjes së standardeve europiane për arsimin e lartë në kuadrin politikëbërës dhe legjislativ, arsimit të lartë në Shqipëri është ende larg realizimit konkret të objektivave dhe standardeve të synuara (Gjonça, 2014; Rrokaj, 2013). Masivizimi i arsimit të lartë, përtej mundësive dhe kapaciteteve, edhe pse një politikë arsimore e rëndësishme në procesin e demokratizimit të vendit, ka ndikuar në rënien e cilësisë së arsimit të lartë (Raporti Final KRALKSH, 2014: 12).

Po sipas këtij raporti, shumica e studentëve në Shqipëri studiojnë në universitete publike (78.5%) dhe shënohet një rritje në studimet me kohë të pjesshme (21.5%).

Ky zgjerim dhe masivizim si në sektorin publik dhe privat nuk u shoqërua me mekanizma kontrolli dhe rregullues normativë, çka i shtoi edhe më sfidat e arsimit të lartë në vend. Për më tepër, investimi në arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor ka qenë i ulët (jo më shumë se 3% e PBB) dhe kryesisht i bazuar tek financimi i 'inputeve' në sistemin e arsimit të lartë, pra për studentët, pagesat e stafit dhe infrastrukturës.

Në të njëjtën linjë shqetësimesh, edhe Komisioni Europian në Progres Raportin për Shqipërinë për vitin 2013 sa i takon arsimit të lartë vëren se pak progres është bërë në reformimin e arsimit të lartë dhe në mbështetjen financiare për zhvillimin e kërkimit dhe inovacionit me qëllim që Shqipëria të bëhet pjesë e Hapësirës Europiane të Kërkimit (EC, 2013: 50). Progres raporti sugjeron nevojën për të bërë një analizë të aftësive dhe profesioneve që kërkohen në treg në nivel kombëtar dhe rajonal dhe më pas këto gjetje të krahasohen me programet e studimit dhe kurrikulat akademike që ofrojnë universitetet shqiptare. Për më tepër, një strategji për mësimin përgjatë gjithë jetës si dhe për arsimin dhe formimin profesional është e nevojshme të ndërtohet (EC, 2013: 50). Gjithashtu, një sfidë e hapur mbetet edhe zhvillimi i një skeme të rankimit të universiteteve në bazë të performancës si dhe zhvillimi i Kuadrit Kombëtar të Kualifikimeve në përputhje me Procesin e Bolonjës dhe prioritetet e arsimit të EUROPA 2020. Sa i takon kërkimit shkencor dhe inovacionit, Komisioni rekomandon investime për rritjen e kapaciteteve njerëzore, përmirësimin e infrastrukturës së kërkimit shkencor, zhvillimin e projekteve kërkimore të përbashkëta me universitete Europiane dhe pjesëmarrja më aktive në skemat e Bashkimit Europian për arsimin e lartë, kërkimin dhe inovacionin.

Nevoja për zhvillimin cilësor të arsimit të lartë në Shqipëri është tashmë e mirëpranuar nga të gjithë aktorët. Në sferën publike janë bërë disa përpjekje për të nxitur debatin rreth reformimit të sistemit të arsimit të lartë në vend përmes publikimeve të shkrimeve në shtypin e përditshëm, emisione televizive, forume në platformat online të komunikimit, konferenca shkencore dhe tryeza të rrumbullakta si edhe përmes botimeve të eseve apo artikujve analitikë lidhur me progresin e deritanishëm dhe sfidat e mëtejshme të arsimit të lartë (Gjuraj, 2013; Tarifa, 2013; Fuga, 2013; Minxhozi, 2013; Rrokaj, 2013). Sa i takon politikëbërjes, në janar 2014 qeveria ndërmorri nismën e ngritjes së Komisionit për Reformën e Arsimit të Lartë\* në vend, të përbërë nga një grup

---

\*Komisioni për Arsimin e Lartë u drejtua nga Prof. Arjan Gjonça (profesor i asociuar në LSE, UK) me një mandat 3-6 muaj. Anëtarët e komisionit përfaqësojnë si sektorin e arsimit publik edhe atë privat, ata janë jo vetëm ekspertë të arsimit të lartë, por edhe aktorë kyç të sektorit. Komisioni me synimin për të qenë i pavarur, diskutoi modele të ndryshme të reformimit të arsimit të lartë para dhe arriti me një propozim për qeverinë në formën e Raportit Final për Reformimin e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor.

ekspertësh të sferës së akademisë dhe kërkimit me qëllim përgatitjen e një reforme të thellë të sektorit duke përfshirë skemat e financimit dhe qeverisjes së universiteteve, raportin publik vs. privat, kërkimin shkencor dhe zhvillimin e kapaciteteve në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe shoqërisë shqiptare. Reformi i arsimit të lartë kërkon që arsimit të konsiderohet si vazhdimësi dhe jo i copëzuar në cikle të ndryshme, duke vënë theksin tek mësimi për gjatë gjithë jetës, si dhe që strategjitë arsimore të përputhen me strategjitë e zhvillimit të vendit (Rrokaj, 2013).

Këto procese e kanë ndikuar rrënjësisht hapësirën universitare në Shqipëri dhe kanë shtuar sfida të reja si kapërcimi i dikotomisë arsimi i lartë publik apo privat dhe ripozicionimi i universiteteve në Shqipëri në kushtet e shoqërisë dhe ekonomisë së dijes.

Në korrik 2014 pas një procesi dialogu të draftit të parë të raportit, Komisioni për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor publikoi Raportin Final për Reformimin e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor duke rekomanduar kështu reformimin e sistemit në tre drejtime kryesore: (i) skema e financimit të arsimit të lartë, e cila do të bazohet tek 'output-et' e sistemit, pra tek tregues të matshëm të performancës së universiteteve dhe jo thjesht në numrin e studentëve; (ii) qeverisja e brendshme e IAL-ve duke balancuar aspektin menaxherial me atë akademik; (iii) arkitektura e arsimit të lartë dhe progresi i studentëve në sistem (Raporti Final KRALKSH, 2014). Raporti rikonfirmon arsimin e lartë si një të mirë publike dhe nënvizon rolin e qeverisë në financim, lehtësim dhe në ushtrimin e mekanizmave të kontrollit. Së dyti, autonomia e IAL-ve konsiderohet si një element thelbësor në sigurimin e një arsimit cilësor. Së treti, sugjerohet që në fazën afatgjatë IAL-të të marrin formën e qendrave jofitimprurëse, por që mund të krijojnë veprimtari fitimprurëse për t'i përdorur në funksion të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor (Raporti Final KRALKSH, 2014: 60).

Në themel qëndron qëllimi për arsim cilësor, për sa më shumë individ.

### 3.2 Përtej dikotomisë arsimi i lartë publik vs. privat

Liberalizimi i arsimit të lartë dhe licensimi i universiteteve private që prej fillimit të viteve 2000 e në vazhdim ka shenjuar të gjithë hapësirën universitare në Shqipëri. Nga njëra anë ky proces ka krijuar më shumë mundësitë për tu arsimuar përmes shtimit të alternativave të zgjedhjes së universitetit, programit të studimit, tarifave, vendndodhjes etj. Për më tepër, universitetet private ofrojnë një model të ri në traditën e arsimit të lartë në Shqipëri sa i takon pavarësisë nga shteti në qeverisje, menaxhim, ndërtim kurrikulash akademike, kërkim shkencor e praktika të përditshme të procesit mësimor (Gjuraj, 2013). Nga ana tjetër, ky proces liberalizimi dhe zgjerimi i arsimit të lartë ka qenë kaotik (Minxhozi, 2012: 103) dhe jo domosdoshmërisht në përputhje me kërkesat e zhvillimit social-ekonomik të vendit dhe kërkesave të tregut të punës.

Politikat e licensimit, rregullimit dhe akreditimit të universiteteve private janë vënë shpesh në qendër të kritikave. Ligjërimi aktual në hapësirën publike dhe në politikëbërje karakterizohet nga një qasje thuajse konfliktuale të përplasjes mes arsimit të lartë publik përkundër atij privat.

Kapërcimi i kësaj dikotomie përbën edhe një ndër dimensionet kryesorë të reformës aktuale të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor. Së pari, është e rëndësishme të nisemi nga parimi se, si universitetet publike ashtu edhe ato private, pra të regjistruara si shoqëri tregtare, i shërbejnë publikut dhe ofrojnë një të mirë publike, pra përgatisin profesionistët e rinj dhe prodhojnë dije. Së dyti, qeveria dhe institucionet si Ministria e Arsimit dhe Agjencia Publike e Akreditimit të Arsimit të Lartë duhet të ndërmarrin një rol më aktiv rregullues sa i takon proceseve të licensimit, akreditimit, rankimit dhe ruajtjes së standarteve të cilësisë si në universitetet publike edhe ato private në përputhje me analizën strategjike të aftësive të nevojshme në tregun e punës në Shqipëri dhe standardet e Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë. Së treti, vlerësimi i programeve të studimit, performancës së stafit akademik, cilësisë së studentëve, kërkimit dhe inovacionit të universiteteve sipas indikatorëve të qartë dhe praktikave më të mira dhe transparencë për publikun për të lehtësuar vendimmarrjen.

Pika kritike në kapërcimin e kësaj dikotomie është statusi që universitetet do të kenë sipas reformës së re të synuar, pra elementë të tillë si financimi, qeverisja, konkurrenca për studentë, procedurat e pranimit etj. Një skemë e mundshme është aplikimi i modelit universitar britanik ku universitetet kanë statusin e organizatave jo fitim prurëse dhe të ardhurat ri-investohen në universitet për infrastrukturë, zhvillim kapacitetesh, kërkim e inovacion dhe nuk shpërndahen si përfitim. Kjo do të bënte të mundur konkurrencën për fonde publike dhe vlerësimin e universiteteve në bazë të performancës së tyre (Gjonça, 2014a). Pavarësisht se deri në çfarë mase do të miratohet modeli i propozuar nga Komisioni për Reformën në Arsimin e Lartë për statusin e IAL-ve si jofitimprurëse dhe skema e financimit bazuar tek performanca, thelbi qendron në sigurimin e zbatimit të parimeve dhe standardeve europiane të pranuar në strategji e kuadër ligjor; ndërtimin e instrumentave konkretë e funksionalë të monitorimit dhe vlerësimit të cilësisë dhe nivelit të përformancës së universiteteve; nxitjen e transparencës dhe llogaridhënies ndaj publikut si nga ana e institucioneve qeveritare të arsimit të lartë ashtu edhe nga ana e universiteteve.

### 3.3 Roli i ri i universiteteve në shoqërinë dhe ekonominë e dijes

Në kontekstin e shoqërisë dhe ekonomisë së dijes, roli në rritje i universitetit si qendër e edukimit, trajnimit, përgatitjes profesionale, kërkimit, inovacionit dhe prodhimit të dijes është formalizuar në modelin e Heliksit të Trefishtë. Sipas propozuesve të këtij modeli (Etzkowitz & Leydesdorff, 2000; Etzkowitz & Viale; 2010; Etzkowitz & Dzisah, 2008) në kushtet e shoqërisë së bazuar tek dija, universiteti formësohet si një universitet me identitet sipërmarrës që nënkupton si një qendër e zhvillimit social-ekonomik, të krijimit dhe shpërhapjes së dijes dhe nxitjes së inovacionit. Kjo realizohet përmes ndërlidhjes dhe ndërtimit të rrjetave të komunikimit dhe bashkëpunimit me sferën e qeverisë dhe biznesit. Kështu për t'iu përgjigjur kërkesave në rritje të shoqërisë bashkëkohore dhe për të përmbushur misionin e ri të universitetit përtej edukimit e drejt sipërmarrjes, ndërtimi i mekanizmave dhe kapaciteteve për manaxhimin e kërkimit dhe projekteve në këtë terren që është në ndryshim të vazhdueshëm bëhet një çështje thelbësore sidomos në kontekste ku mungon një traditë e konsoliduar sikurse në rastin e Shqipërisë.

Shqipëria është karakterizuar përgjatë periudhës së pas Luftës së Dytë Botërore e deri në fillim të viteve 90-të nga modeli etatist i marrëdhënies mes shtetit, industrisë dhe universitetit (Bino & Curraj, 2012: 163). Përgjatë kësaj tradite universitet kanë qenë të fokusuar për nga mësimdhënia dhe nën kontrollin e plotë të shtetit. Ndërkohë me transformimit politike, ekonomike e shoqërore të demokratizimit, universitetet gjithashtu janë në një proces reformimi të vazhdueshëm. Një ndër sfidat e arsimit të lartë në Shqipëri është ridimensionimi i rolit të universiteteve në kushtet e shoqërisë dhe ekonomisë së dijes si universitete të fokusuar për nga kërkimi shkencor dhe inovacioni dhe si universitete sipërmarrëse. Për këtë arsye që universitet shqiptare të ndërtojnë një profil sipërmarrës drejt kërkimit dhe inovacionit, kuadri politikbërës dhe legjislativ për arsimin e lartë është themelor në aspekte të tilla si fondet për kërkim dhe zhvillim, lehtësimi i iniciativave të bashkëpunimit në kuadër të Heliksit të Trefishtë. Kështu fondet për kërkim dhe zhvillim në Shqipëri alokohen vetëm nga qeveria për institucionet e arsimit të lartë publik dhe biznesi nuk është thujse aspak i përfshirë në proceset e inovacionit, kërkimit dhe zhvillimit (Minxhozi, 2012: 103). Për më tepër, sistemit të arsimit të lartë në Shqipëri i mungon specializimi i universiteteve dhe rritja e kontributit të tyre në zhvillimin social-ekonomik të rajonit. Pavarësisht se niveli i Kërkimit dhe Zhvillimit (R&D) në Shqipëri si edhe në vendet e rajonit është i ulët, në kuadër të Europës 2020 po bëhen përpjekje për të përmirësuar situatën. Kështu në tetor 2013 Ministrat e Arsimit dhe Shkencës të Ballkanit Perëndimor nënshkruan një deklaratë për mbështetjen e Kërkimit dhe Zhvillimit për Inovacionin në Rajon (Marinkovic & Dall, 2014: 72). Në linjë me reformën e sipërpërmendur, qëllimi këtu është që investime strategjike dhe politikat të përqëndrohen në përmirësimin e kërkimit shkencor, promovimin e ndërlidhjeve mes shkencës dhe industrisë si dhe rritje të investimeve të biznesit në kërkim dhe inovacion.

Për të lehtësuar ridimensionimin e suksesshëm të universiteteve si universitete sipërmarrëse në kuadër të ekonomisë së dijes dhe Heliksit të Trefishtë është e nevojshme zhvillimi i kapaciteteve njerëzore dhe institucionale si dhe përmirësimi i infrastrukturës për kërkimin shkencor dhe inovacionin në universitet. Kjo nënkupton rritje të fondit për kërkim si dhe mbështetje financiare dhe procedura lehtësuese për kualifikimet e mëtejshme të lektorëve dhe kërkuesve për metodologjinë, aplikimin për grante kërkimore, teknikat e marketimit të rezultateve të kërkimit etj. Gjithashtu, krijimi i strategjive dhe praktikave të manaxhimit të kërkimit në universitet përmes instrumentave të tillë si themelimi dhe konsolidimi i qendrave kërkimore të specializuara, njërive të manaxhimit të projekteve, njërive të zhvillimit të marrëdhënieve me partnerët dhe ndërkombëtarizimit. Për më tepër, është e nevojshme ndërtimi i mekanizmave konkretë të bashkëpunimit me sferën e biznesit për kërkime të aplikuara. Një tjetër element është edhe krijimi i hartës elektronike të publikimit të kërkimit shkencor si një platformë për të ndarë dhe transmetuar dijen dhe për të nxituar bashkëpunimin mes akademikëve dhe universiteteve. Së fundmi, orientimi i kërkimit në shkollat doktorale sipas kërkesave dhe prioritetëve të zhvillimit të vendit apo të rajoneve të veçanta. Ky proces nuk është i izoluar nga dinamikat e tjera të arsimit të lartë në Shqipëri, përkundrazi të gjitha këto procese janë të ndërlidhura dhe kërkojnë një reformë rrënjësore të arsimit të lartë.

## IV. REKOMANDIME

Reformimi i arsimit të lartë në Shqipëri nën dritën e Strategjisë EUROPA 2020 është e nevojshme të kryhet i informuar nga elementët: (i) objektivat dhe prioritetet e zhvillimit social dhe ekonomik të shoqërisë bashkëkohore shqiptare; (ii) analiza strategjike e aftësive, profesioneve dhe profileve që i nevojiten zhvillimit social dhe ekonomik dhe tregut të punës në Shqipëri.

Është e rëndësishme që ky proces reformues të marr parasysh: (i) perspektivën e rolit gjithnjë e më të madh që kërkimi dhe inovacioni kanë për zhvillimin e të gjithë aspekteve të shoqërisë, ekonomisë dhe politikëbërjes; (ii) arsimiti i vazhdueshëm dhe përgjatë gjithë jetës dhe njohja a formimeve akademike, profesionale formale dhe jo formale; (ii) specializimi i profileve të universiteteve, roli i tyre më sipërmarrës dhe kontribues në zhvillimin e rajonit e komunitetit.

Nisur nga analiza e mësipërme disa rekomandime<sup>2</sup> paraprake paraqiten sipas prioriteteve të strategjisë EUROPA 2020 për arsimin e lartë, por të aplikuar në rastin e Shqipërisë.

### (i) Niveli i arsimit të lartë:

- a. Rregullimi i procedurave, kërkesave dhe standardeve të pranimit në universitet;
- b. Sigurimi i mekanizmave efektive të tranzicionit nga kualifikimet profesionale tek programet e studimit në universitet;
- c. Rritja e pjesëmarrjes në arsimin e lartë të grupeve të skajuar në Shqipëri si nga komuniteti Rom, Egjyptian;
- d. Diplomimi në kohë i studentëve përmes përmirësimit të Shërbimeve Studentore në institucionet e arsimit të lartë si edhe udhëzime edhe këshillim për studentët në zgjedhjen e programit të duhur të studimit;
- e. Standardizimi i njohjes së kualifikimeve profesionale, eksperiencave formale dhe joformale të mësimin në progresin akademik.

### (ii) Cilësia dhe rëndësia e arsimit të lartë:

- a. Zhvillimi i kapitalit njerëzor në universitete për mësimdhënie dhe kërkim;
- b. Përshtatja e kurrikulave akademike me kërkesat e zhvillimit social dhe ekonomik të vendit si dhe me tregun e punës përmes përfshirjes së aktorëve të tjerë në procesin e krijimit, vlerësimit dhe përmirësimit të kurrikulave akademike – Bordet e Punës për Departament;
- c. Përdorimi i teknologjive të informacionit dhe komunikimit për të përmirësuar metodologjinë e mësimdhënies, lehtësuara marrëdhënien pedagog-student; ndërtuar platformën elektronike të kërkimit dhe dijes së akumuluar në universitet;

2. Në linjë edhe me dialogun për reformën në arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor.

- d. Ndërtimi i Kuadrit Kombëtar të Kualifikimeve;
- e. Përcaktimi i standardeve të vlerësimit të universiteteve në bazë të performancës;
- f. Zhvillimi i procedurave e sigurimit të cilësisë së brendshme;
- g. Metodologji mësimdhënie e qendëruar tek student, për mirësim i raportit numër stafi akademik për numër studentësh.

**(iii) Ndërkombëtarizimi i arsimit të lartë:**

- a. Ndërtimi i kapaciteteve njerëzore dhe institucionale për bashkëpunimin me universitete dhe aktorë të tjerë në projekte për arsimin e lartë, për kërkimin dhe aktivitete të ngjashme;
- b. Pjesëmarrja në skemat europiane të lëvizshmërisë së stafit dhe studentëve;
- c. Mbështetje e stafit për pjesëmarrje në projekte kërkimore rajonale e më gjerë si dhe në konferenca shkencore e krijimi i hapësirave për publikime.

**(iv) Përforcimi i trekëndëshit të dijes arsim, kërkim dhe inovacion:**

- a. Lidhja e arsimit të lartë, kërkimit dhe inovacionit me zhvillimin sipas parimit të Heliksit të Trefishtë;
- b. Ndërtimi i kapaciteteve njerëzore dhe institucionale për menaxhimin e projekteve dhe kërkimit në universitet përmes qendrave të specializuara të kërkimit; zyrave të zhvillimit të projekteve;
- c. Aftësimi i stafit akademik për të aplikuar për grante kërkimore dhe për të zhvilluar kërkim të orientuar nga politikëbërja;
- d. Mekanizma bashkëpunimi me biznesin në projekte kërkimore të aplikuara si dhe për programe praktike dhe punësimi për studentët;
- e. Marketimi dhe mediatizimi i kërkimit për tu bërë më i prekshëm nga publiku dhe për të ndikuar politikëbërjen;
- f. Krijimi i gjurmuesit për studentët e diplomuar dhe progresin e tyre në tregun e punës.

**(v) Qeverisja e institucioneve të arsimit të lartë, financimi dhe fondet për kërkim dhe zhvillim:**

- a. Kapërcimi i dikotomisë arsim publik vs. privat;
- b. Financim i përqendruar tek studenti dhe jo tek institucioni;
- c. Financimi i kërkimit në bazë të performancës së universitetit sipas indikatorëve vlerësues të mirëpërcaktuar;

---

Në kuadër të Procesit të Bolonjës nën dritën e strategjisë EUROPA 2020 edhe dy dimensione të tjera janë po aq prioritare për Shqipërinë:

**(i) Rritja e pjesëmarrjes së të rriturve në arsim përmes programeve të mësimit për gjatë gjithë jetës:**

- a. Adaptimi i një strategjie për mësimin përgjatë gjithë jetës;
- b. Përforcimi i lidhjes midis edukimit profesional, trajnimeve, eksperiencave të mësimit përmes edukimit informal ose jo-formal dhe mësimit përgjatë gjithë jetës;
- c. Rritja e ndërgjegjësimit për mësimin përgjatë gjithë jetës për të rriturit;
- d. Përmirësimi i këshillimit të karierrës edhe përmes Zyrave të Punës;
- e. Ofrimi i programeve flexible të studimit si edhe i rrugëve të hyrjes në universitet.

**(ii) Arsimi dhe Formimi Profesional:**

- a. Hartimi i një strategjie kombëtare për arsimin dhe formimin profesional në përputhje me standardet europiane dhe kërkesat e tregut të punës në Shqipëri;
- b. Ndërgjegjësimi publik për vlerën e formimit profesional dhe rritja e numrit të studentëve të rregjistruar në arsimin profesional;
- c. Vlerësimi dhe rankimi i institucioneve të arsimit dhe formimit profesional.

## V. BIBLIOGRAFI

Barslund, M., (2012). 'Recent Developments in Selected Education Indicators and their Relation to Europe 2020 Targets', National Institute Economic Review, No. 220, pp. 1-12.

Bino, B., & Curraj, E., (2012). 'Heliksi i trefishtë si "inovacion për inovacionin": dinamika e huazimit të qasjeve nga sipërmarrja për menaxhimin e projekteve dhe kërkimit', Economicus, Nr. 12, fq. 161-178.

Carter, S., Fazey, J., Geraldo, J. L. G., & Trevitt, C., (2010). 'The doctorate of the Bologna Process third cycle: Mapping the dimensions and impact of the European Higher Education Area', Journal of Research in International Education, Vol. 9, No. 3, pp. 245-258.

EACEA/Eurydice, 2011a. Adults in Formal Education: Policies and Practice in Europe. Brussels: Eurydice. Available at: <http://bookshop.EUROPA.eu/en/adults-in-formal-education-pbEC3111017/> [Accessed 29 January 2014].

EACEA/Eurydice, 2011c. Modernisation of Higher Education in Europe: Funding and the Social Dimension. Brussels: Eurydice. Available at: <http://bookshop.EUROPA.eu/en/modernisation-of-highereducation-in-europe-pbEC3211799/> [Accessed 29 January 2014].

Etzkowitz, H., & Viale, R. (2010). 'Polyvalent Knowledge and the Entrepreneurial University: A Third Academic Revolution?'. Critical Sociology, Vol. 36, No. 4, pp. 595-609.

Etzkowitz, H., & Dzisah, J. (2008). 'Rethinking development: circulation in the triple helix'. Technology Analysis & Strategic Management, Vol. 20, No. 6, pp. 653-666.

Etzkowitz, H., & Leydesdorff, L. (2000). 'The dynamics of innovation: from National Systems and "Mode2" to a Triple Helix of university-industry-government relations'. Research Policy, Vol. 29, pp. 109-123.

European Commission. (2013). 'Albania 2013 Progress Report', marrë nga [http://ec.EUROPA.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/2013/package/al\\_rapport\\_2013.pdf](http://ec.EUROPA.eu/enlargement/pdf/key_documents/2013/package/al_rapport_2013.pdf), aksesuar më 20 Dhjetor 2013.

European Commission. (2011). 'Structural change in research institutions: Enhancing excellence, gender equality and efficiency in research and innovation'. Luxembourg: Publications Office of the European Union.

---

Fuga, P., (2013). Universiteti dhe kërkimi: Reforma e vonuar e sistemit shqiptar. Tiranë: UET Press.

Gjonçaj, A., (2014). 'Arsimi i Lartë, revolucioni që po vjen', marrë nga <http://revistajava.al/sociale/2014127/arsimi-i-larte-revolucioni-qe-po-vjen>, aksesuar më 1 Shkurt 2014.

Gjonçaj, A., (2014a). 'Universitetet do të reformohen: më shumë konkurrencë dhe standarde në treg', Gazeta Mëpo, 29 Janar, , marrë nga <http://mepo.al/2014/01/29/gjonca-universitetet-te-reformohen-shume-konkurrence-dhe-standard-ne-treg/>, aksesuar më 31 Janar 2014.

Gjonçaj, A., (2014b). 'Më shumë punë shkencore në universitetet shqiptare', Gazeta Mëpo, 10 Janar, marrë nga <http://mepo.al/2014/01/10/arjan-gjoncaj-shume-pune-shkencore-ne-universitetet-shqiptare/> , aksesuar më 29 Janar 2014.

Gjonçaj, A., (2013). 'Modeli universitar britanik dhe aplikimi në Shqipëri', Tryezë e rumbullakët me aktorë të arsimit të lartë në Shqipëri, Nëntor 2013, marrë nga <http://www.uetcentre.org/portal/index.php/en/home/93-news/230-dynamics-of-higher-education-and-scientific-research-in-albania-lessons-from-britain-prof-arjan-gjoncaj> , aksesuar më 29 Janar 2014.

Gjuraj, T., (2013). Ide të sistemuara për arsimin e lartë privat dhe publik, Tiranë: UET Press.

Minxhozi, L., (2013). Universiteti për zhvillimin: Origjina, modelet dhe impakti në shoqëri. Tiranë: UET Press.

Marinkovic, I., & Döll, E., (Eds) (2014) R&D and Innovations in Western Balkans, Moving Towards 2020. Center for Social Innovation, Vienna.

Minxhozi, L., (2012). 'Universitetet sipërmarrëse dhe roli i tyre në zhvillimin e inovacionit në shoqëritë e së ardhmes', Economicus, Nr. 12, fq. 96-106.

Powell, J. J. W., Bernhard, N., & Graf, L., (2012). 'The Emergent European Model in Skill Formation: Comparing Higher Education and Vocational Training in the Bologna and Copenhagen Processes', American Sociological Association, Vol. 85, No. 3, pp. 240-258.

Raporti Final për Reformimin e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, (2014), Komisioni për Reformën në Arsimin e Lartë, marrë nga <http://www.arsimi.gov.al/al/arsimi/universiteti/reforma-e-arsimit-te-larte-dhe-kerkimit-shkencor> , aksesuar më 12 Shtator 2014.

Rrokaj, Sh., (2013) 'Reforma në arsim, jetike për sot dhe për të ardhmen', marrë nga <http://www.shtetiweb.org/2013/07/10/reforma-ne-arsim-jetike-per-sot-dhe-per-te-ardhmen/>, aksesuar më 17 Janar 2014.

Tarifa, F., (2013). Arsimi i lartë për një shoqëri të hapur. Tiranë: UET Press.

Strategjitë – Arsimi, Kërkimi, Zhvillimi dhe Inovacioni – Shqipëria

- Këshilli i Ministrave. (2008). Strategjia Kombëtare për Arsimin e Lartë 2008-2013, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Tiranë.

- Këshilli i Ministrave. (2008). Strategjia Ndërsektoriale e Shoqërisë së Informacionit 2008-2013, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, Tiranë.

- Këshilli i Ministrave. (2013). Draft Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2014-2020. Tiranë.

- Këshilli i Ministrave. (2008). Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2007-2013. Tiranë.

- Ministria e Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjitikës. (2007). Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2007-2013. Tiranë.

- Këshilli i Ministrave. Strategjia e Inovacionit dhe Teknologjisë së Biznesit, mbështetur nga Bashkimi Europian.

- Këshilli i Ministrave. (2009). Strategjia Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin 2009-2015, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, Tiranë.

- Ministria e Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjitikës. (2011). Programi Strategjik për Zhvillimin e Inovacionit dhe Teknologjisë për SME-të: 2011 – 2016, Tiranë.

- Ministria për Inovacionin, Teknologjinë e Informacionit dhe Komunikimit.(2012). Shqipëria Dixhitale dhe E-biznesi, Tiranë.



# POLITIKAT E PUNËSIMIT DHE TË ARSIMIT E FORMIMIT PROFESIONAL

## Sa afër e larg 'EUROPA 2020'

Autorë: **Dokt. Sidita Dibra; M.A. Alma Shkreli; M.A. Besjana Kuci**

### Përmbledhje Ekzekutive

Ndryshimet e thella të mjedisit ekonomik, social dhe politik gjatë këtyre 24 viteve të tranzicionit në Shqipëri kanë nxitur, ndër të tjera, domosdoshmërinë e hartimit të politikave të përshtatshme aktive të tregut të punës për të trajtuar ndryshimet strukturore ekonomike drejt sektorit të shërbimeve dhe domosdoshmërinë e fuqizimit të sektorit bujqësor, përbëlljen me plakjen e pop-ullsisë, pabarazinë gjinore, integrimin e grupeve të cënueshme, etj. Krahas emergjencave të brend-shme, objektivi strategjik i integritimit në Bashkimin Evropian (BE) ushtron presionin për përafrim të politikave kombëtare me ato të BE-së, përfshirë këtu dhe ato të punësimit dhe aftësive.

Në Mars 2010, BE ka shpallur strategjinë e re "EUROPA 2020" për rritje të zgjuar, të qëndrueshme dhe përfshirëse, ku në drejtim të politikave aktive të tregut të punës është hartuar "Agjenda për Punë dhe Aftësi të Reja" me qëllim reduktimin e segmentimit të tregut të punës, efikasitetin e sistemit të taksave dhe përfitimeve, vëmendjen ndaj grupeve të cënueshme, përshtatjen jetë-punë dhe përfshirjen gjinore, trajtimin e plakjes së popullsisë, nxitjen e dialogut social, zbatimin e sistemit të përafruar të kualifikimeve dhe certifikimit të aftësive. Qëllimi i këtij dokumenti politikash është të analizojë nivelin e përafrimit të politikave tona kombëtare për punësimin dhe Arsimin dhe Formimin Profesional (AFP) - si ofruesi i aftësive të lidhura direkt me punën - me orientimet e BE-së si dhe të japë disa rekomandime në këtë drejtim.

Mjedisi i politikave të AFP-së dhe punësimit në Shqipëri karakterizohet nga një dinamizëm i lartë. Pas përpjekjeve fillestare nga qeveria e kaluar për integrimin e arsimit dhe formimit profesional, aktualisht e gjithë përgjegjësia për ofruesit e AFP-së është përqendruar në MMSR me synimin për të afruar sa më tepër këtë sektor me politikat e tregut të punës. Për këtë qëllim, është miratuar "Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësim (2014-2020)" me orientimet kryesore strategjike si nxitja e mundësive për punë përmes politikave efektive të tregut të punës, ofrimi i AFP-së cilësore për të rinj e të rritur, promovimi i përfshirjes sociale e kohezionit territorial, dhe fuqizimi i drejtimit të tregut të punës dhe sistemit të kualifikimeve. Në këtë kuadër, nga MMSR me ndihmën teknike të donatorëve, është realizuar një vlerësim i të gjithë ofruesve publikë dhe po përgatitet baza e plotë ligjore për sigurimin e zbatimit të politikave reformuese.

---

Nga analiza e politikave të mëparshme dhe atyre të miratuara së fundmi, është konstatuar se progres është bërë në drejtim të fleksibilitetit horizontal dhe vertikal të AFP-së përmes rritjes së mundësive për zgjedhjen e drejtimeve profesionale dhe fraksionimit të niveleve të studimit, por efektiviteti është i ulët pasi një masë e papërfillshme nxënësish e ndërpresin ciklin e studimeve në një nivel të caktuar për tu punësuar. Ndërsa politikat për adresimin e grupeve të cënueshme dhe të rriturve të papunë, janë përqendruar në rritjen e përfitimeve sociale në rast angazhimi në AFP si dhe financimin e tarifës së kurseve afatshkurtra, por edhe në këtë drejtim, niveli i përfshirjes në AFP dhe sidomos në tregun e punës është në shifra mjaft të ulëta. Në strategjinë e re për Punësim dhe Aftësi 2014-2020, ka objektiva konkrete për përfshirjen gjinore dhe të të rriturve, por mungojnë nismat e përshtatura për këtë grup të synuar. Parashikohet gjithashtu dhe një plan nismash për zhvillimin rural si dhe fuqizimin e shërbimit të punësimin. Sistemi i ri fiskal, pritet të favorizojë përfshirjen në tregun e punës të personave me kualifikim dhe pagë të ulët, por mungojnë politikat konkrete të nxitjes së vetëpunësimin, sidomos të të rinjve.

Rekomandohet që në politikat shqiptare të nxitjes së punësimin dhe AFP të parashikohen nisma konkrete të përfshirjes në tregun e punës. Kështu sugjerohen politika më konkrete, të përshtatura për përfshirjen e femrave apo nxitjen e vetë-punësimin.

## I. HYRJE

Shqipëria ka pësuar ndryshime të thella të mjedisit ekonomik, social dhe politik gjatë këtyre 24 viteve të tranzicionit dhe aktualisht përballet me sfida të veçanta për tregun e punës dhe zhvillimin e aftësive. Vendi aktualisht karakterizohet nga një ekonomi me normë pozitive rritjeje, por në rënie. Ndryshimet strukturore pas viteve '90, kanë krijuar tashmë një mjedis biznesi që mbizotërohet jo nga organizatat e mëdha por nga SME-të (që zënë 95% të ndërmarrjeve); jo më industria por sektori i shërbimeve përbën kontributin kryesor në GDP (me rreth 66%) dhe punëson rreth 30% të forcës së punës (ndërsa industria kontribuon në 16% të GDP dhe 23% të punësimit); ndërsa bujqësia, pas kolapsit në fillim të tranzicionit, aktualisht zë rreth 18% të GDP, madje ka shënuar rritje në këto vite (edhe pse njëshifrore) të punësimit dhe produktivitetit të punës, por vazhdon të jetë i pazhvilluar dhe përgjithësisht jo konkurrues, pavarësisht politikave për reformimin e sektorit dhe ndihmës së huaj.

Popullsia në Shqipëri gjatë periudhës së tranzicionit është karakterizuar nga një mobilitet i lartë që vitet e fundit ka ndryshuar tipologji. Nëse në dekadën e parë të tranzicionit, gati gjysëm milion shqiptarë emigruan përtej kufijve, në dekadën e dytë (që nga viti 2001), janë kthyer rreth 138 mijë (Census, 2011). Ndërkohë lëvizja nga zonat rurale drejt qendrave urbane ka qenë e vazhdueshme duke rritur papunësinë e këtyre zonave. Nga ana tjetër ulja e lindshmërisë ndër vite ka shkaktuar rritjen e përqindjes së popullsisë së aftë për punë (brezi 15-64 vjeç, aktualisht zë 68.3% nga 63.2% të popullsisë në 2001), rritje kjo që parashikohet të rritet deri në vitin 2020 dhe pastaj të ulët.

Gjatë këtyre viteve tranzicion, në një mjedis dinamik ekonomiko-social, qeveritë e radhës kanë ndërmarrë politika të ndryshme aktive të tregut të punës me qëllim aftësimin profesional dhe rritjen e punëzënies, por sidoqoftë niveli i papunësisë është i lartë sidomos për kategori si femrat, grupet e cënueshme, të rinjtë deri në 24 vjeç apo banorët në zonat rurale ku pjesëmarrja në tregun e punës është me e ulët dhe e orientuar drejt bujqësisë. Sipas Anketës së Forcave të Punës nga INSTAT, pjesëmarrja e të rinjve (15-29 vjeç) në tregun e punës është vetëm 41.4%. Gjithashtu, pjesëmarrja në formimin profesional dhe arsimin e mesëm vijon të jetë jo në nivele të dëshirueshme. Rreth 20% e nxënësve – shifër kjo në rritje gjatë tre viteve të fundit - regjistrohen në arsimin profesional, pjesëmarrje kjo e ulët krahasuar me vendet e rajonit apo mesataren e BE, dhe akoma më e ulët kur merret në konsideratë që rreth 35% e të rinjve në Shqipëri nuk ndjekin arsimin e mesëm.

Aktualisht, mjedisi i politikave të sektorit të punësimit dhe aftësimit profesional karakterizohet nga një dinamizëm i lartë dhe sfida të mëdha. Duke marrë shkas nga segmentimi i ofertës së AFP-së si pasojë e përgjegjësisë të ndara mes Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (MASH), për arsimin profesional dhe Ministrisë së Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (MPÇSHSHB), për formimin profesional dhe si rrjedhojë e mungesës së koordinimit mes institucioneve ofruese të arsimit profesional

dhe atyre të formimit profesional, në fund të mandatit të qeverisë së kaluar, nisi puna për hartimin e strategjisë së përbashkët mes këtyre dy Ministrive. Qeveria e re në fuqi që në Qershor 2013, ka thelluar reformën në sektor duke përqendruar të gjitha përgjegjësitë për sistemin AFP-së nën Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (MMSR)<sup>3</sup> dhe afrimin e këtij sektori me politikat e punësimit. Në këtë frymë të re, në Shkurt 2014 është miratuar Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësim (SKPA) 2014-2020 ku bashkërendohet vizioni politik për arsimin e formimin profesional dhe për punësimin. Orientimet e SKPA 2014-2020 dhe të Planit të Veprimit, janë reflektuar në ligjin e rishikuar të AFP-së( miratuar më 26.06.2014), dhe në veprimet e ndërmarra në vazhdimësi nga MMRS dhe aktorët e tjerë.

Aktualisht pas miratimit nga Parlamenti i Shqipërisë të ligjit të ndryshuar të AFP-së i cili reflekton kalimin e përgjegjësive nga njëra ministri tek tjetra por edhe ndryshime të tjera reformatore, po përgatitet nga ekspertë vendas dhe ndërkombëtarë një set aktesh nën-ligjore për zbatimin e këtij ligji. Gjithashtu, për një vendimmarrje të informuar në këtë fazë transferimi i përgjegjësive tek MMSR, si dhe me qëllim përgatitjen e planeve të ardhshme të zhvillimit të këtyre institucioneve ofruese me qëllim racionalizimin e ofertës publike të AFP-së është ndërmarrë nga MMSR me mbështetjen e Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH (GIZ) dhe European Training Foundation (ETF), një studim bazë i të gjithë ofruesve publikë të AFP-së, 42 Shkolla të Mesme Profesionale dhe 10 Qendra të Formimit Profesional.

Përpos sfondit të mësipërm politiko-social, Shqipëria ka si objektiv strategjik integrimin në Bashkimin Evropian (BE) dhe si rrjedhojë, rrugëtimi drejt arritjes së këtij objektiv nënkupton përafrimin e politikave të zhvillimit, ndër të cilat dhe ato të punësimit dhe ngritjes së kapitalit njerëzor. BE ka lançuar Strategjinë "EUROPA 2020" për rritje të zgjuar, të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse ku punësimi dhe aftësimi profesional (nën emërtesën "Afhenda për Punë dhe Aftësi të Reja") është një ndër orientimet strategjike si për vetë BE ashtu dhe për vendet që aspirojnë të jenë pjesë e familjes Evropiane. Në këtë kuadër, qëllimi i këtij dokumenti është të analizojë politikat aktuale të Punësimit dhe AFP-së dhe sa janë ato të përafruara me orientimet përkatëse të "EUROPA 2020".

## II. ANALIZA E PROBLEMIT

Vitet e fundit Shqipëria ka formuluar politika të shumta në fushën e Punësimit dhe AFP-së të cilat kanë shërbyer si udhërrëfyese të reformave të vazhdueshme të sektorit. Efektiviteti i këtyre politikave nuk është konstatuar plotësisht, por nëse i referohemi progres raportit të fundit të Komisionit Evropian (KE) për Shqipërinë në vitin 2013, në kapitullin 19 thuhet se: "Shënohet pak progres në fushën e politikave sociale dhe të punësimit... Janë bërë disa përpjekje në drejtim të antidiskriminimit dhe mundësive të barabarta por është e nevojshme të investohen më shumë burime njerëzore dhe financiare në zbatimin e politikave respektive në nivel qendror dhe lokal.

Në përgjithësi, përgatitjet në fushën e politikës sociale dhe punësimit nuk janë shumë

3. Dikur Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (MPÇSHSHB)

të avancuara” (f.35). Por konkretisht, cilat janë disa nga politikat apo reformat konkrete të ndërmarra në këtë sektor që kanë rezultuar në një situatë të tillë? Më poshtë analizohen këto politika të kategorizuara sipas orientimeve të “EUROPA 2020” për Punësimin dhe Zhvillimin e Aftësive. Gjithashtu, duke prezantuar dhe politikat e sektorit të cilat janë miratuar së fundmi apo po diskutohen momentalisht si orientime deri në 2020, do mund të arsyetohet sa janë të orientuara politikat kombëtare të punësimit dhe AFP-së drejt nismës Evropiane Axhenda për Punë dhe Aftësi të Reja.

### *1. Politika në drejtim të fleksibilitetit dhe sigurisë<sup>4</sup> me qëllim reduktimin e segmentimit të tregut të punës dhe lehtësimin të tranzicionit (në tregun e punës) si dhe lehtësimin e balancës punë – familje*

Siç dhe u prezantua në sfondin e përgjithshëm, tregu i punës në Shqipëri është i segmentuar dhe më pak të përfshirë në tregun e punës janë femrat, të rinjtë, personat me nivel të ulët arsimimi dhe kualifikimi, banorët e zonave rurale, të varfrit dhe kategoritë e tjera të cënueshme. Në këtë kuadër, janë ndërmarrë disa politika aktive për gjithëpërfshirjen në tregun e punës, politika këto që përshkruhen më poshtë.

Me qëllim nxitjen e fleksibilitetit dhe integrimin sa më shpejt në tregun e punës, kurrikula e Arsimit Profesional është reformuar në vitin 2009 si në drejtim të kohëzgjatjes ku maksimumi i ciklit të studimeve për një drejtim do ishte 4 vjet, si dhe në drejtim të strukturës ku përveç sistemit tradicional 4-vjeçar në bllok, (tashmë në vetëm 2 drejtime profesionale), ofrohen dhe struktura të fraksionuara në tre nivele (2+1+1) ose dy nivele (2+2). Në përfundim të secilit nivel nxënësi pajiset me çertifikatë, gjë që teorikisht dhe parimisht krijon parakushtet për fleksibilitet horizontal dhe vertikal në sistemin arsimor profesional si dhe në tregun e punës. Sidoqoftë, analiza e statistikave të shkollave profesionale tregon se pavarësisht fleksibilitetit vertikal që ofrohet, kalimi në tregun e punës pas përfundimit të nivelit të parë apo të dytë është pothuajse inekzistent dhe nxënësit ndjekin nivelet e tjera në vijim deri në përfundim të 4 viteve. Gjithashtu, pas përfundimit të 4 viteve shkollë, niveli i punësimit është i ulët.

Reforma e vitit 2009 i krijon mundësi nxënësve të arsimit profesional që të aplikojnë për tu pranuar në Universitet. Të ndihmuar dhe nga rritja e kuotave për pranim në arsimin e lartë në vitet e kaluara, një përqindje gjithnjë e më e lartë e nxënësve që mbarojnë arsimin profesional regjistrohen në universitet duke devijuar në këtë mënyrë qëllimin final të arsimit të tyre fillestar.

Gjithashtu, një iniciativë tjetër që shkon në drejtim të fleksibilitetit dhe të ofrimit të AFP për grupe të ndryshme është edhe AFP pas i mesëm, dy vjeçar. Në bazë të ligjit të rishikuar të AFP-së, është futur në sistemin arsimor edhe arsimi pas i mesëm, si një mundësi për aftësimin e të rinjve të cilët kanë mbaruar arsimin e përgjithshëm. Nisma është ndërmarrë në Universitetin e Durrësit në bashkëpunim me

4. ‘Flexicurity’ është termi i përdorur për të përshkruar bashkimin e dy koncepteve, fleksibilitet dhe siguri, si një model i mirëqenies sociale i përbërë nga politika aktive.

shkollën profesionale, për degën e informatikës, ku të rinjtë kanë një mundësi të hyjnë në tregun e punës pas dy viteve AFP-së, pas studimeve të mesme, duke marrë në këtë profesion njohuritë bazë. Për momentin janë 2 institucione jo-publike që ofrojnë arsim profesional pas të mesëm me 4 programe studimi, ndërsa në sistemin arsimor publik janë 3 institucione të arsimit të lartë me 10 programe gjithsej. Me zbatimin e reformës në arsimin e lartë pritet që të krijohen Kolegjet profesionale për të ofruar shkollim profesional 1-2-vjeçar me të drejtën e lëshimit të një Diplome Profesionale. Gjithashtu, disa degë në universitete publike të cilat nuk arrijnë të sigurojnë shërbimin e pritshëm si institucione të arsimit të lartë apo oferta e tyre nuk përkon me nevojat e tregut të punës, të ridimensionohen dhe të propozojnë cikle të formimit profesional me kohëzgjatje 1 ose 2 vite, pas të cilave studentët pajisen me diploma profesionale dhe dalin në tregun e punës. (MAS, 2014).<sup>5</sup>

Një sfidë në drejtim të përfshirjes dhe kohezionit social përbën dhe rritja e pjesëmarrjes në tregun e punës të grupeve të cënueshme, veçanërisht atyre me aftësi të kufizuara si dhe mundësi të barabarta për pjesëmarrje në tregun e punës në zonat rurale, veçanërisht malore, në raport me ata urbane. Për momentin, këto grupe janë adresuar më tepër nga politika pasive të tregut të punës përmes pensioneve të invaliditetit dhe pagesave të papunësisë, por numri i të regjistruarve në zyrat e punës nga këto kategori është mjaft i ulët. Sipas Shërbimit Kombëtar të Punësimit (SHKP), në vitin 2013, grupet e cënueshme (romë dhe egjiptianë, viktimat e trafikut, persona me aftësi të kufizuara, emigrantë të kthyer, jetimë) përbëjnë vetëm 9.7% të të papunëve të regjistruar. Gjithashtu, rreth 60% e punëkërkuesve të papunë janë afatgjatë dhe sipas ligjit nr. 9570 dt 03.07.2006, përfshihen në kategorinë e grupeve të veçanta të papunësisë. Ndërkohë sukcesi i punësimit të kësaj kategorie është përgjithësisht i ulët. Sipas SHKP, në vitin 2011 vetëm 1.1% e të punësuarve (të regjistruar si punëkërkues të papunë) i përkasin kategorisë së grupeve të cënueshme.

Gjithashtu, për disa nga grupet e cënueshme (gratë e trafikuar, vajzat nëna, romët dhe egjiptianët, personat me aftësi të kufizuara, emigrantët e kthyer), ekzistojnë vendime të veçanta të nxitjes së përfshirjes së tyre në arsim<sup>6</sup> dhe në kurset e formimit profesional përmes përjashtimit nga tarifa e regjistrimit (dhe dyfishimit të pagesës për paaftësinë për PAK). Sidoqoftë, kjo nisëm nuk duket të jetë mjaft efektive përsa kohë vetëm 1.1% e të të trajnuarve janë nga grupet e disavantazuara.

Dhe në këtë favorizim ka një shkallë diskriminimi, pasi të varfrit apo fëmijët e këtyre familjeve, nuk përfitojnë nga këto stimuj. Pjesëmarrja e femrave në AP aktualisht vijon të jetë e ulët, duke i privuar në këtë mënyrë kualifikimin përkatës dhe përfshirjen eventuale në tregun e punës.

Me qëllim përfshirjen dhe kohezionin social, është përgatitur draft Strategjia për Përfshirje dhe Mbrojtje Sociale 2013-2020 me në fokus grupet e disavantazuara dhe me pjesëmarrje të ulët në tregun e punës si: personat me aftësi të kufizuara

5. [http://www.arsimi.gov.al/files/userfiles/reformaalksh/Raport\\_Final\\_Ministria\\_Arsimit.pdf](http://www.arsimi.gov.al/files/userfiles/reformaalksh/Raport_Final_Ministria_Arsimit.pdf)

6. Në 2012 MASH ka përcaktuar kuota për PAK dhe studentët romë e egjiptianë, por këto mundësi janë ofruar vetëm në nivelin universitar.

(PAK), komuniteti rom dhe egjiptian, gratë në nevojë, fëmijët në risk, të rinjtë, dhe të moshuarit. Kjo strategji është e integruar me Strategjinë Kombëtare të PAK dhe planin e veprimit 2012-2020, Plani i Veprimit të Dekadës Rome 2005-2015, si dhe Strategjinë Kombëtare të Barazisë Gjinore dhe Uljes së Dhunës kundër Grave 2011-2015. Progres raporti i fundit i KE e vlerëson këtë draft strategji si "gjerësisht e konsultuar dhe përfaqëson një qasje të re gjithëpërfshirëse ku anti-diskriminimi është një shtysë e rëndësishme për të arritur përfshirjen sociale" (f.34).

Një politikë në dëm të "flexicurity" është politika mbi pensionin e pleqërisë e cila nuk e inkurajon pensionin e parakohshëm para plotësimit të viteve të caktuara të punës (zakonisht 30)<sup>7</sup> pasi pensionet janë mjaft të ulëta dhe të pamjaftueshme për të jetuar.<sup>8</sup> Përfshirja e kësaj kategorie (të rriturit nga 24-64 vjeç) në formimin profesional është gjithashtu e ulët (vetëm 1%), në raport me nevojën e këtij grupi të synuar me nivel të lartë papunësie si mbartës kryesorë të kostos së ristrukturimit të ekonomisë. Ligji i ri për sigurimet shoqërore i propozuar nga Këshilli i Ministrave dhe i miratuar nga Parlamenti, nuk parashikon ndryshime thelbësore në drejtim të flexicurity por rritje graduale të moshës së pensionit dhe rritje të viteve të punës.<sup>9</sup>

Strategjia Ndërsektoriale për Zhvillimin Rajonal (METE 2007) është konstatuar si një mundësi e mirë për ndërtimin e kuadrit institucional dhe ligjor në drejtim të menaxhimit efektiv të politikës rajonale. Në këtë strategji janë përfshirë elementë si indeksimi i zhvillimit, synimi i zonave të disavantazuara, partneriteti, etj. Në këtë kuadër janë ndërtuar dhe Strategjitë e Zhvillimit të Qarqeve bashkë me planet operationale, financiare dhe monitoruese, por akoma nuk janë përpiluar strategjitë e zhvillimit të burimeve njerëzore.

"Strategjia për Punësim dhe Aftësim 2014-2020" e miratuar në Shkurt 2014, ka si një ndër orientimet kryesore strategjike "nxitjen e përfshirjes sociale dhe kohezionit territorial", me qëllim adresimin e grupeve të disavantazuara dhe ofrimin e mundësive të AFP-së për individë me aftësi të ulëta. Një fokus të veçantë parashikohet të ketë mbulimi i zonave rurale me shërbime punësimi dhe AFP, nisëm kjo që pritet të arrihet në bashkëpunim me të tjera institucione qendrore dhe në kuadër të "Strategjisë Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor në Shqipëri", ku ndër objektivat deri në 2020 janë dhe "krijimi i 100 mikro-ndërmarrjeve dhe i 30.000-35.000 vendeve të reja të punës në zonat rurale përmes diversifikimit të aktiviteteve që krijojnë të ardhura; krijimi i 20 000 vendeve të punës në aktiviteteve përpunuese bujqësore; krijimi i 50.000 vendeve të punës në aktivitete jo bujqësore dhe shërbime të tjera". (MBUMK, f. 55-56)

Një tjetër prioritet strategjik i parashikuar në "Strategjinë për Punësim dhe Aftësim 2014-2020" i cili pritet të ndikojë pozitivisht në "flexicurity" është dhe "Nxitja e mundësive për punë të denjë nëpërmjet politikave të frytshme të tregut të punës"

7. <http://www.iss.gov.al/index.php/perfitues/pension-i-pleqerise> Viertel dhe Nikolovska, (2010), f. 55

8. [http://www.parlament.al/web/pub/p\\_ligji\\_sig\\_shoqerore\\_17828\\_1.pdf](http://www.parlament.al/web/pub/p_ligji_sig_shoqerore_17828_1.pdf)

9. [http://www.parlament.al/web/pub/p\\_ligji\\_sig\\_shoqerore\\_17828\\_1.pdf](http://www.parlament.al/web/pub/p_ligji_sig_shoqerore_17828_1.pdf)

ku parashikohet (i) modernizimi i shërbimit kombëtar të punësimit përmes rritjes së eficiencës së zyrave rajonale e lokale të punësimit dhe krijimit të një Agjencie Kombëtare të Punësimit; (ii) rritja e përputhshmërisë me standardet ndërkombëtare të punësimit që ndër të tjera pritet ta përgatisë tregun shqiptar të punës me atë Evropian; (iii) zgjerimi i gamës dhe shtrirjes së shërbimeve dhe programeve të punësimit duke përfshirë këtu nisma me ndjeshmëri gjinore dhe orientimin në karrierë, një fushë kjo me mjaft mangësi aktualisht pavarësisht përpjekjeve të bëra për lëndë të veçanta në shkollat e mesme dhe 9-vjeçare; (iv) përmirësimin e monitorimit dhe vlerësimit të masave të punësimit me ndjeshmëri për çështjet gjinore. Në planin e veprimit të kësaj strategjie janë parashikuar nisma që ndër të tjera i adresohen dhe grupeve të veçanta. Detajimi në aktivitete konkrete, përcaktimi i institucioneve përgjegjëse për realizimin e tyre, buxhetimi dhe përcaktimi i treguesve të monitorueshëm, janë hapa pozitivë në drejtim të zbatueshmërisë dhe monitorimit të kësaj strategjie.

## ***2. Rishikimi dhe monitorimi i efikasitetit të sistemit të taksave dhe përfitimeve, me fokus tek personat me kualifikim të ulët si dhe heqja e masave që dekurajojnë vetëpunësimin***

Sipas Progres Raportit të KE, mbulimi me përfitimet e papunësisë mbetet i ulët dhe vlerësohet rreth 6% të totalit të numrit të të papunëve të regjistruar dhe ka disa përpjekje për luftimin e punës së padeklaruar (f. 34).

Aktualisht, pagesa e papunësisë është një përfitim, tarifa e të cilit rregullohet me ligj dhe është 6,340 lekë.<sup>10</sup>

Individët me status të veçantë dhe familjet në nevojë përfitojnë nga ndihma ekonomike dhe në vitin 2013 numri i përfituesve është ulur me 30%, kjo si pasojë e shtrëngimit të kushteve për të përfituar një pagesë të tillë por njëkohësisht është rritur fondi i parashikuar për përfitimet me 54%.<sup>11</sup> Tarifat e kësaj ndihme variojnë sipas numrit të anëtarëve të familjes në ngarkim si dhe statusit përkatës, por një individ i papunë mbi 18 vjeç përfiton një ndihmë ekonomike prej 2,600 Lekë.<sup>12</sup> Këto përfitime janë mjaft të ulëta krahasuar me pagën minimale prej 22,000 Lekë.<sup>13</sup> Ndërsa në drejtim të vetëpunësimit, hapja e një biznesi ishte më e thjeshtë por raporti i fundit i Bankës Botërore e rendit Shqipërinë 8 vende më poshtë se vitin e kaluar edhe pse procedurat dhe kostoja e çeljes së një biznesi është e ulët.<sup>14</sup> Ndërsa biznesi mund të jetë i thjeshtë për tu regjistruar, nuk ka aktualisht një sistem fiskal që lehtëson nga barra e pagesave individët e vetëpunësuar.

Politika më e re fiskale e miratuar nga qeveria në Dhjetor 2013 pritet të inkurajojë punësimin e individëve me kualifikim dhe eventualisht pagë të ulët, pasi për pagat deri në 30.000 Lekë, tatimi mbi të ardhurat është zero dhe zbritja e vetme nga paga janë sigurimet shoqërore dhe shëndetësore. Është akoma shumë herët për të parashikuar

10. [http://www.zrp-tr.gov.al/index.php?option=com\\_content&view=article&id=47&Itemid=67](http://www.zrp-tr.gov.al/index.php?option=com_content&view=article&id=47&Itemid=67)

11. [http://open.data.al/sq/lajme/lajm/lang/sq/id/705/Ndihma-ekonomike-per-familjet-ne-nevoje-\(2006---2013\)](http://open.data.al/sq/lajme/lajm/lang/sq/id/705/Ndihma-ekonomike-per-familjet-ne-nevoje-(2006---2013))

12. [http://www.shssh.gov.al/index.php?option=com\\_content&view=article&id=40&Itemid=17](http://www.shssh.gov.al/index.php?option=com_content&view=article&id=40&Itemid=17)

13. <http://www.eksk.com/attachments/article/170/VKM%20573%20dt%2003%2007%2013%20Per%20pagen%20minimale%20one%20shkalle%20vendi.pdf>

14. <http://www.doingbusiness.org/data/exploreconomies/albania/#starting-a-business>

si kjo politikë e re fiskale do ndikojë në inkurajimin e punësimit të personave me kualifikim të ulët, por ajo që pritet është së pari favorizimi i punësimit të personave me kualifikim të ulët dhe së dyti, që të ardhurat e disponueshme të kësaj kategorie të jenë më të larta.

Orientimet e reja strategjike në "Strategjinë për Punësim dhe Aftësim 2014-2020" në drejtim të promovimit të përfshirjes sociale, parashikojnë reformimin e sistemit të asistencës sociale për të shmangur humbjet dhe adresimin e personave në nevojë. Ndërsa në drejtim të vetëpunësimit, në këtë strategji parashikohet promovimi i sipërmarrjes sociale, sidomos në sektorin shërbimit.

Një tjetër program për nxitjen e punësimit me fokus të veçantë tek grupet e cënueshme si femra, punëkërkuar të papunë të rinj pa profesion, të papunë që përfitojnë pagesë papunësie dhe ndihmë ekonomike, të papunët afatgjatë, personat mbi 45 vjeç që nuk kanë një arsimim më të lartë se arsimiti i mesëm ose ekuivalent të tij, personat me aftësi të kufizuara, personat nga komuniteti rom dhe emigrantët e kthyer me probleme ekonomike. Punëdhënës të ndryshëm aplikojnë për këtë një fond i cili subvencionon pagesën e sigurimeve shoqërore për një vit dhe katër paga për çdo punonjës të punësuar. Sipas raporteve të MMSR, ky fond është tre - fishuar këtë vit dhe numri i bizneseve aplikuese është katër - fishuar.

Ndër politikat aktualisht në proces diskutimi mes donatorëve (projekti EU-ILO IPA 2010) dhe MMSR, në drejtim të efikasitetit të sistemit të taksave dhe përfitimeve dhe nxitjes së punësimit dhe aftësimin, është dhe krijimi i "Fondit Kombëtar për Nxitjen e Punësimit dhe Zhvillimit të Zotësive". Një fond i tillë parashikohet të mbledhet si kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe pritet të jetë 0.5% mbi pagën, ku 0.25% do të paguhet nga punëdhënësi e 0.25% nga punëmarrësi.

### *3. Promovimi i formave të reja të balancës punë – jetë dhe i politikave aktive në kuadër të plakjes së popullsisë si dhe me qëllim rritjen e barazisë gjinore*

Siç dhe u prezantua në sfondin e përgjithshëm, popullsia e Shqipërisë po shkon drejt një plakjeje graduale dhe politikat aktive të tregut të punës duhet të jenë në pararojë dhe të përshtaten me këtë trend. Aktualisht janë hedhur hapat e parë të disa politikave për përfshirjen më të lartë të të rinjve në tregun e punës gjatë arsimimit, nëpërmjet programit të nxitjes së punësimit dhe formimit në punë.<sup>15</sup>

Lidhur me politikat aktive për përfshirjen e femrave përmes AFP, akoma konstatohet që drejtimet dhe profilet e ofruara aktualisht nga sistemi janë të tilla që tërheqin më shumë djem<sup>16</sup> dhe ky disbalancim ekziston në të gjithë territorin madje më e theksuar

15. <http://www.kerkojopune.gov.al/wp-content/uploads/2014/02/web-vkm47.pdf>

16. Sipas MASH (2010), mbi 67% e nxënësve në AP ishin djem

në zonat rurale ku femrat kanë më pak akses në AP (GIZ, 2011, p.19).

Femrat janë më tepër të orientuara në drejtime profesionale ku kanë më shumë mundësi punësimi. Në AP, femrat janë regjistruar në drejtime si turizmi, ekonomia dhe biznesi, ndërsa në FP në kurse si parukeri-estetikë apo rrobaqepësi. Femrat pastaj vijnë të jenë të disavantazuara në drejtim të aksesit në tregun e punës pasi hasin diskriminim në punësim si dhe përgjithësisht kanë paga më të ulëta se meshkujt (Viertel dhe Nikolovska, 2010). Plani i Veprimit i Strategjisë për Punësim dhe Aftësim (2014-2020), për të arritur orientimin strategjik të përfshirjes sociale, ka parashikuar dhe objektiva konkrete të uljes së diferencës mes femrave dhe meshkujve në 13% në drejtim të nivelit të pagave dhe 10% lidhur me pjesëmarrjen në tregun e punës. Në këtë dokument strategjik, nuk parashikohen politika konkrete që do të çojnë në arritjen e këtyre objektivave.

#### *4. Dhënia e një impulsi të fortë të zbatimit të KEK përmes vendosjes së KSHK*

Në aspektin e Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KSHK), progres është shënuar në hartimin dhe miratimin e Ligji për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve (Ligji Nr 10247, datë 04.03.2010, "Për Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve"). Ky ligj identifikon të gjitha llojet e kualifikimeve duke njohur diplomat / certifikatat përkatëse. Po ashtu ai u jep mundësinë të rinjve që janë pjesë e sistemit për lëvizur vertikalisht dhe horizontalisht si për të nxënëit formal ashtu dhe jo-formal. Korniza Shqiptare e Kualifikimeve në strukturë është e njëjtë me Kornizën Evropiane të Kualifikimeve (KEK). KSHK synon zhvillimin, njohjen dhe dhënien e kualifikimeve në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me standardet e njohurive, aftësive dhe kompetencave që duhet të arrihen nga studentët dhe të trajnuarit/kursantët.

Gjithashtu, miratimi i ligjit të KSHK ka sjellë ndryshime në ligjin e AFP-së miratuar në Qershor 2011. Një nga ndryshimet kryesore është struktura e arsimit profesional e cila bazohet në strukturën e kualifikimeve të formimit profesional të parashikuara sipas KSHK.

Me gjithë suksesin e shënuar në hartimin e KSHK, dhe në miratimin ligjit po ashtu, çfarë mbetet përsëri për tu bërë është zbatimi i ligjit dhe lidhja e kurrikulave të të gjitha programeve në të gjitha nivelet me kualifikimet e parashikuara në KSHK. Në Strategjinë së Punësimit dhe Aftësimit (2014-2020) përmes objektivit D2: Zbatimi i KSHK, synohet operacionalizimi i ligjit për KSHK, rishikimi i përshkrimeve të niveleve të KSHK-së sipas standardeve profesionale, si dhe rishikimi dhe lidhja e kurrikulave me KSHK.

Aktualisht, pas miratimit të ligjit të rishikuar të AFP-së, është hartuar dhe lista e akteve nënligjore që nevojiten për zbatimin e ligjit. Një ndër aktet që aktualisht po punohet nga ekspertë ndërkombëtar të mbështetur nga GIZ dhe ILO, është udhëzimi i ministrit të MMRS mbi "Standartet, kriteret, dhe procedurat e akreditimit për programet mësimore dhe institucionet e arsimit dhe formimit profesional", me një referencë të

fortë kundrejt zbatimit të standarteve KSHK.

**5. *Sigurimi që kompetencat e kërkuara për tu përfshirë në të mësuarit/nxënit e mëtejshëm dhe në tregun e punës, përfitohen dhe njihen në arsimin e përgjithshëm, profesional, të lartë dhe të të rriturve, duke përfshirë dhe të nxënit formal e informal.***

Ky udhëzim është pothuajse i pa prekur në Shqipëri dhe zbatimi i këtij udhëzimi ka një rrugë të gjatë dhe ndërlihet ngushtësisht me zbatimin e KSHK-së, me riformulimin e ligjit të AFP-së, krijimin e Këshillave Kombëtare për Punësimin dhe AFP-në, këshillave sektorial si dhe hartimin dhe zbatimin e të gjitha ligjeve dhe akteve nën ligjore të lidhura me këto elemente.

Aktualisht po bëhen disa përpjekje nga MMSR që brenda kuadrit ligjor të AFP-së (Disa ndryshime në ligjin Nr. 8872, datë 29.3.2002 "Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Nr. 63/2014) të integrohen koncepte të vlerësimit të AFP-së (Neni 12), dhe duke ia vënë si detyrë funksionale AKAFPK, krijimin e një sistemi unik të kualifikimeve (Neni 16). Në Strategjinë për Punësim dhe Aftësim (2014-2020) përmes objektivit D2: Përpunimi dhe zbatimi i KSHK, synohet krijimi i mekanizmave për njohjen e të nxënit të mëparshëm, konkretisht specifikohet në D2.4: Përzgjedhja e organeve dhe përcaktimi i procedurave për vlefshmërinë e kualifikimeve, vlerësimin e aftësive, certifikimin dhe përcaktimin e vlefshmësisë/ njohjen e të nxënit të mëparshëm dhe kjo detyrë parashikohet të realizohet nën përgjegjësinë kryesore të AKAFPK me mbështetjen teknike të donatorëve.

**6. *Zhvillimi i partneritetit mes botës së arsimit/formimit dhe të punës, në veçanti duke përfshirë partnerët socialë në planifikimin e ofrimit të arsimit dhe trajnimit, dhe promovimi e monitorimi i zbatimit efektiv të rezultateve të dialogut social.***

Një nga udhëzimet kryesore të BE-së është edhe përfshirja e partnerëve socialë në të gjitha proceset e politikëbërjes në lidhje me punësimin dhe AFP-në.

Partneriteti Social është një nga pikat më pak të zhvilluara në këto 23 vite në funksion të sistemit të AFP-së në Shqipëri. Mungesa e platformave konkrete dhe efektive për bashkëpunimin dhe kontributin e Partnerëve Socialë në sistemin e AFP-së ka bërë që shpesh vendimet për AFP-në në lidhje me atë çfarë ofrohet, si ofrohet dhe cilësia apo standardet e ofrimit të jenë vetëm përgjegjësi e Qeverisë Qendrore, Ministrive përgjegjëse, në të kaluarën Ministria e Arsimit dhe Shkencës apo dhe Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

Gjatë këtyre viteve janë bërë mjaft përpjekje për zhvillimin e këtij partneriteti si nga projekte të ndryshme (mbështetur nga Qeveria Austriake, Gjermane, Zvicerane, nga BE etj.) ashtu dhe nga qeveria Shqiptare, si në nivel qendror ashtu dhe në nivel lokal, pra nivel shkolle apo qendre formimi profesional.

Megjithatë këto nisma shpesh kanë mbetur në kuadër pilotimesh apo dhe në kuadër

formal, sepse zbatimi ka qenë gjithnjë i kufizuar dhe kushtet e përshtatshme për bashkëpunim kanë munguar. Mund të përmendim që ka pasur vullnet politik nga palët por shpesh ka munguar informimi i bizneseve, shoqatave, dhomave të tregtisë, sindikatave, marrja në konsideratë e nevojave të tyre reale dhe kapaciteti i tyre për të qenë kontribues dhe vendimmarrës për politikat e lidhura me sistemin e AFP-së.

Në nivel strategjik një nga iniciativat e qeverisë shqiptare në këtë drejtim është dhe Marrëveshja e Partneritetit Social në vitin 2008. Nënshkrues të kësaj marrëveshje ishin përfaqësues të sindikatave dhe përfaqësues të biznesit në Shqipëri. Megjithëse kjo marrëveshje ka mbetur akoma në letër aktualisht, kohët e fundit ajo është marrë si model për vazhdimësinë dhe zhvillimin e kësaj nisme me anë të marrëveshjes mes MMRS-së, institucioneve vartëse dhe organizatave të biznesit, si Business Albania.<sup>17</sup>

Në Strategjinë për Punësim dhe Aftësim (2014-2020) si dokumenti më i fundit strategjik i përgatitur nga MMSR me asistencën teknike të donatorëve, dhe siç u përmend më herët, parashikohen disa masa për zhvillimin e partneritetit mes botës së arsimit e formimit dhe punës, në nivelin strategjik dhe politik, po ashtu dhe në nivel ofruesi të AFP-së. Partneriteti Social preket shumë pak në analizën e problematikave brenda kësaj strategjie, megjithatë në planin e veprimit të kësaj strategjie janë parashikuar disa masa brenda prioriteteve strategjike, në përmirësimin e bashkëveprimit me Partnerët Social. Konkretisht në Prioritetin Strategjik D. Forcimi i qeverisjes së tregut të punës dhe sistemit të kualifikimeve janë parashikuar objektivat D1.3 Forcimi i rolit të Këshillit Kombëtar të Punësimit dhe D.1.4

Krijimi i Këshillit Kombëtar të Punësimit dhe AFP-së me qëllimin për të arritur përfshirjen e Partnerëve Social në të gjitha nivelet e vendimmarrjes për AFP-në. Pozitiv është fakti që në këtë strategji dhe në planin e veprimit është marrë angazhimi që arsimit dhe formimi profesional të realizohet në bashkëpunim me biznesin apo palët e treta, si në hartimin e standardeve profesionale, kurrikulave po ashtu dhe në zbatimin e AFP si një sistem dual apo praktik.

Po ashtu në ligjin e rishikuar të AFP-së<sup>18</sup> parashikohet krijimi i bordeve të institucioneve ofruese të AFP-së si një formë e zbatimit të dialogut social. Në këtë ligj garantohet gjithashtu që autonomia e institucioneve ofruese në fushën e kurrikulave, financimeve, stafit dhe menaxhimit në nivel ofruesi do të ofrohet në mënyrë efektive si rezultat i kornizës së re ligjore dhe krijimit të strukturave menaxhuese, pra bordit.

Në bazë të ligjit, ky bord ka në përbërjen e tij përfaqësues të biznesit dhe i ngarkon ato me drejtimin e bordit<sup>19</sup>. Në nivel kombëtar, ajo çfarë çalon përsëri në Shqipëri, si në politikat sociale të punësimit ashtu dhe ato të AFP-së, është monitorimi i zbatimit efektiv të rezultateve të dialogut social, apo të nismave që kanë për qëllim krijimin e dialogut social.

17. <http://www.biznesalbania.org.al/?p=1642>

18. Pas kalimit të përgjegjësisë për AFP tek MMSR, është miratuar dhe Ligji Nr. 63/2014 "Për disa ndryshime në Ligjin nr. 8872, datë 29.3.2002, "Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar". Ndërsa ky është një ligj kalimtar, një paketë e plotë ligjore po përgatitet nga MMSR me ndihmën e ekspertëve kombëtar e ndërkombëtar

19. <http://vet.al/legal/ligje>

Çfarë mbetet akoma në pikënisje është monitorimi i zbatimit efektiv të rezultateve të dialogut social. Kjo është një çështje në të cilën institucionet e AFP-së, ministrinë përkatëse dhe qeveria shqiptare nga njëra anë por edhe nga donatorët, partnerët socialë apo aktorë të tjerë nga ana tjetër duhet dhe mund të fokusohen në të ardhmen.

### III. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Fundi i mandatit të qeverisë së kaluar dhe ardhja e qeverisë së re, ka shënuar ndryshime të rëndësishme dhe riorientim të politikave të punësimit dhe zhvillimit të aftësive. Nevoja për koordinim të ofertës së arsimit dhe formimit profesional, bashkoi MASH dhe MPCSSHB, që në bashkëpunim me donatorët hartuan draft strategjinë e Të Nxënit Gjatë Gjithë Jetës, nisëm kjo që nga qeveria e re u shty disa hapa më tej në drejtim të afrimit të ofertës së integruar të AFP me politikën e punësimit. Në këtë kuadër, aktualisht përgjegjësitë mbi sistemin e ofruesve të AFP dhe punësimin janë përqendruar pranë MMSR. Me qëllim koordinimin e politikave të punësimit dhe AFP-së, është miratuar "Strategjia për Punësim dhe Aftësi (2014-2020)" dhe orientimet kryesore strategjike të saj janë: (i) nxitja e mundësive për punë përmes politikave efektive të tregut të punës; (ii) ofrimi i AFP cilësor për të rinj e të rritur; (iii) nxitja e përfshirjes sociale dhe e kohezionit territorial; dhe (iv) fuqizimi i qeverisjes së tregut të punës dhe i sistemeve të kualifikimit. Për çdo prioritet strategjik, janë parashikuar dhe nisma më konkrete dhe objektiva. Në kuadrin e reformës në këtë sektor, me qëllim marrjen e vendimeve të bazuara në fakte, nga MMSR me asistencën e donatorëve, janë ndërmarrë studime paraprake në nivel ofruesi të AFP publik si dhe po përgatitet një kuadër i plotë ligjor për të saktësuar përgjegjësitë në sistem dhe për të rritur eficiencën e zbatimit të politikave.

Procesi i hartimit të politikave të punësimit dhe zhvillimit të aftësive në Shqipëri është shoqëruar me një bashkëpunim të gjerë me aktorë ndërkombëtarë dhe sidomos të agjensive të financuara nga Bashkimi Evropian (ETF) apo shtete të veçanta (GIZ, SDC, KK/ADA etj.) ndaj dhe përafërimi me politikën Evropiane të këtij sektori ka qenë i natyrshëm.

Analiza e realizuar për politikën aktuale dhe ato që janë në plan për t'u zbatuar në drejtim të punësimit dhe aftësive, është zhvilluar nën filtrat e nismës së "Axtendës për Punë dhe Aftësi të Reja". Këtu evidentohen qartë sa të përafëruara janë këto politika kombëtare me orientimet strategjike në kuadër të "EUROPA 2020" si: (i) fleksibiliteti në hyrje dhe reduktimi i segmentimit në tregun e punës; (ii) efikasiteti i sistemit të taksave dhe përfitimeve, me fokus tek personat me kualifikim të ulët si dhe heqja e masave që dekurajojnë vetëpunësimin; (iii) balanca punë – jetë dhe i politikave aktive në kuadër të plakjes së popullsisë si dhe me qëllim rritjen e barazisë gjinore; (iv) zbatimi i KEK përmes vendosjes së KKK; (v) njohje dhe certifikim i kompetencave të përftuara gjatë të nxënimit formal e informal; dhe (vi) zhvillimi i partneritetit mes botës së punës/arsimit dhe të punës, në veçanti duke përfshirë partnerët socialë në planifikimin e ofrimit të arsimit dhe trajnimit dhe monitorimi i zbatimit të rezultateve

---

të partneritetit social. Nga sa u tha më sipër dilet në përfundimin se:

- Struktura mësimore e Arsimit Profesional, ka ndryshuar nëdrejtim të fleksibilitetit horizontal dhe vertikal, duke u ri organizuar që në vitin 2009, nga 4 vjet bllok, në tre nivele (2+1+1) ose dy nivele (2+2). Sidoqoftë, niveli i largimit nga shkolla pas çdo niveli me qëllim punësimin është i ulët dhe gjithnjë e më tepër nxënësit e AP aplikojnë për universitet. Pritet që rritja e numrit të institucioneve që do të ofrojnë diploma 2 vjeçare me orientim profesional dhe praktik, sipas modelit aktual të shkollave të sistemit pas të mesëm, do të ndikojë në uljen e rregjistrimeve në universitete dhe rritjen e ofertës me individë të kualifikuar në drejtime profesionale që janë më afër tregut të punës.

- Politikat aktive të përfshirjes së grupeve të cënueshme (gratë e trafikuar, vajzat nëna, romët dhe egjiptianët, personat me aftësi të kufizuar, emigrantët e kthyer) në tregun e punës, janë limituar në orientimin e tyre drejt formimit profesional (kurse afatshkurtra) dhe mbulimin e kostove të kursit si dhe rritje të përfitimeve sociale. Kategoria e fëmijëve të familjeve të varfra nuk përfitojnë nga këto avantazhe. Pavarësisht, pjesëmarrja e grupeve të disavantazuata në formim dhe punësim është mjaft e ulët. Pritet gjithashtu që Strategjia për Përfshirje dhe Mbrotjtje Sociale 2013-2020 me në fokus grupet e disavantazuara, të ketë ndikim në të ardhmen.

- Plani i veprimit në Strategjinë e Punësimin dhe Aftësimin (2014-2020), për të arritur orientimin strategjik të përfshirjes sociale, ka parashikuar dhe objektiva konkrete të uljes së diferencës gjinore në drejtim të nivelit të pagave dhe pjesëmarrjes në tregun e punës, por akoma, nuk janë parashikuar politika konkrete që do çojnë në arritjen e këtyre objektivave. Një situatë e ngjashme ekziston dhe për rritjen e pjesëmarrjes në formimin profesional dhe shkallës së punësimin të të rriturve.

- Mbulimi i zonave rurale me shërbime punësimi dhe AFP, në bashkëpunim me të tjera institucione qendrore e lokale, është një nisëm që pritët të realizohet në kuadrin e strategjisë së re, së bashku me një sërë nismash ndërministrrore (Strategjia e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural) në drejtim të realizimit të prioriteti strategjik të "Krijimit të mundësive më të mira të punësimin përmes politikave efektive të tregut të punës".

- Në bazë të prioritetit strategjik "Krijimit të mundësive më të mira të punësimin përmes politikave efektive të tregut të punës", pritët të fuqizohet koordinimi i ofertës dhe kërkesës për punë përmes krijimit të një Agjencie Kombëtare të Punësimin si dhe të zgjerohet gama e shërbimit duke përfshirë dhe orientimin në karrierë. Parashikimi i një buxheti të veçantë për këtë nisëm, përbën një ndër garancitë e realizimit, por sidoqoftë, vlerësimi i kësaj politike pritët të realizohet në një periudhë më të vonshme.

- Paketa e re fiskale e miratuar në Dhjetor 2013 që prek dhe tatimin mbi të ardhurat, pritet të inkurajojë punësimin e individëve me kualifikim dhe eventalisht pagë të ulët, pasi për pagat deri në 30000 lekë, tatimi mbi të ardhurat është zero. Reformimi i sistemit të asistencës sociale për të shmangur humbjet dhe adresimin e personave në nevojë, është gjithashtu një prioritet në strategjinë e re.

- Në drejtim të nxitjes së vetëpunësimit, në strategjinë e re parashikohet promovimi i sipërmarrjes sociale, sidomos në sektorin e shërbimit. Nuk janë parashikuar politika konkrete të nxitjes së vetëpunësimit në përgjithësi.

Në drejtim të përafrimit të politikave kombëtare të punësimit dhe AFP me "Axhendën për Punë dhe Aftësi të Reja", në kuadër të "EUROPA 2020", rekomandohet:

- Parashikimi i nismave dhe i politikave konkrete në drejtim të reduktimit të segmentimit të tregut mbi baza gjinie dhe moshe. Mund të jetë e nevojshme, një analizë më e kujdesshme e tipologjisë së kësaj kategorie dhe zhvillimin e asaj oferte të AFP-së që siguron integrim të qëndrueshëm, p.sh., formimin me qëllim riintegrimin e të rriturve në kushtet e ristrukturimit ekonomik, apo zhvillimin e atyre profileve në AFP, më të përshtatshme për femrat, si kujdesi shëndetësor etj., duke adresuar jo vetëm çështjen e kualifi kimit dhe integritit të femrave në tregun e punës, por dhe ofrimin e disa shërbimeve tashmë emergjente në kuadrin e plakjes së popullsisë (kujdesi ndaj të moshuarve) dhe pjesëmarrjes së femrave në tregun e punës (kujdesi ndaj fëmijëve).

- Aktualisht nuk ka një sistem të lehtësimit fiskal për të rinjtë nga AFP të cilët duan të vetëpunësohen. Duke vëzhguar dhe praktikën e disa drejtimeve në sektorin e shërbimit ku investimet fillestare nuk janë të larta dhe sukcesi i sipërmarrjes varet nga mjeshtëria e specialistit (si parukieri p.sh., ku kursantet vetëpunësohen), ofrimi i stimujve fiskale që mund të jenë ulje në minimum i tarifave të tatim taksave që mund të paguajnë këta të rinj, do inkurajonte vetëpunësimin. Të rinjtë e vetëpunësuar, sugjerohet të parashikohen si kategori e veçantë në fondin e punësimit. Një nisëm e tillë duhet të koordinohet me politikat e tjera të zhvillimit ekonomik dhe nxitjes së sipërmarrjes.

- Prioritet mund të kenë dhe ato sektorë ku është parashikuar hapja e vendeve të punës (paralelisht me politikat ekonomike eventuale), kryesisht në bujqësi, ku sipas planit të qeverisë në këtë sektor dhe strategjisë përkatëse sektoriale, parashikohen dhe vende pune dhe zhvillim kapacitetesh.

- Në kuadrin e politikave të integruara publike, nga shteti mund të ofrohen stimuj fiskalë (p.sh., mbulim nga shteti i sigurimeve shoqërore e shëndetësore apo përjashtimi nga tatimi mbi të ardhurat), për ato biznese të cilët operojnë dhe punësojnë të diplomuar apo certifikuar nga AFP në ato sektorë të cilët janë identifikuar si prioritarë për zhvillimin ekonomik të vendit.

---

- Ndarja e përgjegjësive për zhvillimin e sistemit të AFP-së mes institucioneve shtetërore dhe partnerëve socialë është një nevojë emergjente për Shqipërinë. Zhvillimi i partneritetit social si në nivel strategjik ashtu dhe në nivel zbatimi është në hapat e parë dhe ka nevojë për më shumë stimuj, më shumë vëmendje konkrete. Në të ardhmen e afërt është i nevojshëm dhe krijimi i një sistemi monitorimi për efektet pozitive të nismave dhe rezultatet e partneritetit social.

## IV. BIBLIOGRAFI

Draft Strategjia Life Long Learning (2013-2020) [http://www.etf.EUROPA.eu/webatt.nsf/O/2F2ABAD2B5A1126EC1257B650030CA17/\\$file/TRP%202012%20Albania\\_EN.pdf](http://www.etf.EUROPA.eu/webatt.nsf/O/2F2ABAD2B5A1126EC1257B650030CA17/$file/TRP%202012%20Albania_EN.pdf)

Komisioni për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor, (2014), "Raporti Përfundimtar për Reformimin e Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor", Tiranë, Korrik 2014, [http://www.arsimi.gov.al/files/userfiles/reformaalksh/Raport\\_Final\\_Ministria\\_Arsimit.pdf](http://www.arsimi.gov.al/files/userfiles/reformaalksh/Raport_Final_Ministria_Arsimit.pdf)

Ligji Nr. 63/2014, "Për disa ndryshime në ligjin nr. 8872, datë 29.3.2002, "Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar

Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (MBUMK), 2014, "Strategjia Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor në Shqipëri"

Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, (2014), "Plani i Veprimit dhe Treguesit për Strategjinë Kombëtare për Punësim dhe Aftësim 2014-2020", [http://www.sociale.gov.al/files/documents\\_files/14-07-04-06-10-00Albania\\_EMP-SKILLS\\_STRATEGY\\_ActionPlan\\_2014\\_.pdf](http://www.sociale.gov.al/files/documents_files/14-07-04-06-10-00Albania_EMP-SKILLS_STRATEGY_ActionPlan_2014_.pdf)

Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, (2014), "Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2014-2020 - Aftësi më të larta dhe punë më të mirë për të gjithë femrat dhe meshkujt"

Projektligj "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr.7703, datë 11.5.1993, "Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të Ndryshuar", Korrik 2014, [http://www.parlament.al/web/pub/p\\_ligji\\_sig\\_shoqerore\\_17828\\_1.pdf](http://www.parlament.al/web/pub/p_ligji_sig_shoqerore_17828_1.pdf)

Shërbimi Kombëtar i Punësimin, (2014), "Buletini i Tregut të Punës", <http://www.kerkojpune.gov.al>

Strategjia EUROPA 2020 "Commission Staff Working Document Albania 2013 Progress Report" Progres ra-porti i KE: Brussels, 16.10.2013, SËD(2013) 414 final

Viertel, E., Nikolovska, M., (2010), "Albania Review Of Human Resources Development", Evropean Training Foundation, ISBN: 978-92-9157-595-4

Xhumari, M., (2013), "Social and civil dialogue as a neë instrument of good governance in Albania", paper presented at Good Governance in Developing Countries conference, Tirana, December, 2013

Heitmann, W., Pasha, A., Dibra, S., Huibregtse, A., Shkreli, A., GIZ & ETF, (2014) 'Studimi Bazë i Ofruesve Publik të AFP-së në Shqipëri, raporti final, [http://www.sociale.gov.al/files/documents\\_files/ALB-Report-Survey-Public-VET-Provider\\_20\\_06\\_14\\_FINAL\\_](http://www.sociale.gov.al/files/documents_files/ALB-Report-Survey-Public-VET-Provider_20_06_14_FINAL_)



# KËRKIMI SHKENCOR DHE INOVACIONI: ADRESIMI I SFIDAVE DHE ROLIT TË MUNGUAR TË SEKTORIT PRIVAT

Autorë: Dr. Elona Dhëmbo; M.A. Erisa Lame; M.A. Elira Hroni

## I. HYRJE

Vende të ndryshme kanë specifikat e tyre për sa i takon politikë-bërjes në fushën e Shkencës dhe Inovacionit, bazuar kryesisht në eksperiencat e kaluara, zhvillimin ekonomik, situatën politike si dhe kuptueshmërinë kulturore dhe publike mbi shkencën dhe kërkimin shkencor. Në kontekstin e krizës ekonomike globale, shumë vende të zhvilluara kanë rritur investimet në K&ZH dhe kanë përdorur politikat e Inovacionit si një instrument për të siguruar burime të reja rritjeje. Kriza ekonomike globale dhe masat që po ndërmerren për të nxitur rritjen ekonomike në vendet e Bashkimit Evropian po ndikojnë në modelimin e politikave të BE duke reflektuar në të njëjtën kohë ndryshime edhe në politika të cilat më parë ishin konsideruar si sferë plotësisht e dominuar nga politika kombëtare. Për pasojë, nëse vendet në zhvillim, përfshirë edhe Shqipërinë, nuk do të reflektonin të njëjtën kuptueshmëri dhe përqasje ndaj problematikës, hendeku midis vendeve të zhvilluara dhe atyre në zhvillim vetëm do të zgjerohej. Që kjo të mos ndodhë, kërkohen shpenzime më të shumta dhe më të mira (efikase dhe eficient) në Kërkim dhe Inovacion.<sup>20</sup> Efektiviteti i investimeve në këtë sektor është edhe më i madh në vendet në zhvillim.<sup>21</sup> Për këtë duhet të jetë i interesuar shteti dhe aktorët e tij, por me të njëjtin seriozitet edhe biznesi. Kështu, studimet e Bankës Botërore në rajonin tonë (Ballkanin Perëndimor, BP) mbi impaktin e K&ZH dhe Inovacionit, tregojnë se:

- Kompanitë novatore janë rritur 15% më shpejt në shitje dhe 8% më shpejt në produktivitet;
- Shpenzimet e kompanive të fokusuara në K&ZH rrisin me 14% pagat dhe produktivitetin e punës me 7%;<sup>22</sup>

20.Në fakt arritja e targetit të vendosur në Agjendën e Lisbonës prej 3% të PPB për zhvillimin e Kërkimit dhe Inovacionit mund të rezultojë shumë shpërblyese si në rastin e Bullgarisë dhe Rumanisë me një rritje të eksporteve prej 8 dhe 13 përqind respektivisht.

21.Griliches, Z.(1979) Issues in assessing the contribution of research and development to productivity growth. Bell Journal of Economics 10 (1), 92-116, 1979.

Harrison, R., et al. (2008). "Does Innovation Stimulate Employment? A Firm-Level Analysis Using Comparable Micro-Data From Four European Countries," NBER WORKING PAPER SERIES <http://eprints.ucl.ac.uk/18867/1/18867.pdf>; Lederman dhe Maloney (2003) for estimates of social rates of return for R&D; Lederman dhe Saenz (2003). "Innovation around the World: A Cross-Country Data Base of Innovation Indicators." Mimeographed. Office of the Chief Economist for LCR, The World Bank, Washington, DC.

22.Western Balkan Regional R&D Strategy for Innovation, October, 2013

Shqipëria, edhe pse e angazhuar në rrugën e rritjes dhe forcimit të sektorit të Kërkimit dhe Inovacionit në nivel politikash, ndër të tjera edhe me një strategji kombëtare, rezulton pak produktive në perspektivë krahasuese ndërkombëtare dhe rajonale.<sup>23</sup> Ajo mbetet mbrapa në shumë indikatorë të K&ZH dhe Inovacionit dhe përballat me sfidën e madhe të zhvillimit të kapitalit njerëzor si dhe parandalimin e largimit të të mirë-kualifikuarve (f. 12). Shqipëria ka dështuar veçanërisht në angazhimin dhe përfshirjen e sektorit privat. Investimet e sektorit privat në shkencë dhe teknologji janë

jashtëzakonisht të ulëta në Shqipëri. Bashkëpunimi midis industrisë dhe universiteteve është nga më të ulëtët në rang botëror duke e renditur Shqipërinë të 139-tën nga 144 shtete.<sup>24</sup> E gjithë kjo kufizon mundësitë për rritje, por nga ana tjetër tregon për një potencial të madh ende të pashfrytëzuar. Në këtë kontekst, ky dokument kërkon të risjellë në vëmendje sektorin e K&ZH dhe Inovacionit në Shqipëri. Ky dokument do të eksplorojë nëse politikat aktuale të K&ZH dhe Inovacionit janë në të njëjtën linjë dhe / apo reflektojnë objektivat e strategjisë së BE 2020. Përmes evidencave nënvizohen problematikat më të mprehta, e në këtë kuadër, edhe pikat më të dobëta, veçanërisht ajo e përfshirjes dhe rolit të sektorit privat. Nga ana tjetër, dokumenti ofron rekomandime konkrete për politikë-bërjen dhe aktorët relevant si dhe shembuj të suksesshëm nga rajoni, si ato të Sllovenisë dhe Serbisë me qëllim nxitjen e debatit dhe ndërmarrjen e masave konkrete për përforcimin e K&ZH dhe Inovacionit në Shqipëri.

### *Produktet e Kërkimit dhe Inovacionit shqiptar*

- Performanca shkencore e Shqipërisë është e dobët. Bazuar në një nga indikatorët e cilësisë – impaktin e citimeve, për periudhën 2003-2010, Shqipëria vlerësohej me 0.72, e dyta në Ballkan pas Serbisë me 0.74, por larg mesatares së BE-27 prej 1.30.
- Në rajon, Shqipëria rezulton të jetë më e specializuar në shkencat e tokës dhe planetare, në shkencën e mjedisit, atë të mikrobiologjisë dhe imunologjisë, por performon dobët veçanërisht në shkencat inxhinierie. Mospërputhja e kësaj të fundit me sektorët më vitalë të ekonomisë shqiptarë në vitet e fundit kërkon analiza të mëtejshme.
- Progresi i teknologjisë është gjithashtu i ngadaltë. Treguesit e patentave e konfirmojnë këtë.

23.Ibid si dhe "Raporti përfundimtar për reformën në arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor 2014" [http://www.arsimi.gov.al/files/userfiles/reformaalksh/Raport\\_Final\\_Ministria\\_Arsimit.pdf](http://www.arsimi.gov.al/files/userfiles/reformaalksh/Raport_Final_Ministria_Arsimit.pdf)

24.World Bank, 2013 Western Balkans Regional R&D Strategy for Innovation, Country Paper Series, ALBANIA.

## II. SITUATA DHE PROBLEMI

Shqipëria, një vend i vogël, në një nga rajonet më pak të zhvilluara të Evropës, përballet edhe pas më shumë se 20 vjet zhvillimi dhe progresi ekonomik, me nivel relativisht të ulët të të ardhurave. Jo rrallë herë kjo përbën edhe justifikimin për mungesën e investimeve të nevojshme në shumë sektorë, duke përfshirë edhe K&ZH dhe Inovacionin. Jo më pak i rëndësishëm është edhe fakti se Kërkimi dhe Inovacioni nuk shihen si nxitës së zhvillimit dhe rritjes, dhe si rezultat politikat e K&ZH dhe Inovacionit vuajnë nga mos-koordinimi, mungesa e angazhimit publik dhe investimeve. Këto politika janë të pjesshme, afatshkurtra dhe të ndikuara nga cikli politik, gjithashtu.

Sot, Shqipëria është ndjeshëm pas vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor dhe vendeve të Bashkimit Evropian për sa i takon kapaciteteve kërkimore dhe novative. Kjo performancë e dobët lidhet veçanërisht me një infrastrukturë të dobët, produkte shkencore të varfra, dhe më një përfshirje dhe angazhim të dobët të aktorëve relevantë ku spikat mungesa e rolit të sektorit privat. Kjo performancë e dobët është evidentuar edhe në raportin përfundimtar mbi reformimin e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor në vend të publikuar në Korrik 2014.<sup>25</sup>

### Si performon Shqipëria në fushën e K&ZH dhe Inovacionit?

Shqipëria është politikisht e angazhuar për të çuar përpara progresin në fushën e K&ZH dhe Inovacionit. Në prill të vitit 2009, së bashku me vende të tjera të BP ajo u angazhua përmes një dokumenti të përbashkët ndër-ministerial për rritjen e bashkëpunimit rajonal për promovimin e Inovacionit. Po kështu, në nivel kombëtar, në vitin 2009 u hartua Strategjia Kombëtare e Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit 2009-2015 me vizion "(i) arritjen e një niveli të mjaftueshëm të kërkimit për të mbështetur

#### Infrastruktura

- Infrastruktura e K&ZH në Shqipëri është e varfër. Ashtu si para dhe pas hartimit të strategjisë kombëtare, ende nuk ka qendra funksionale lokale dhe rajonale të kërkimit, dhe as parqe të teknologjisë dhe inovacionit. Ende ka mungesa të ndjeshme në mjetet teknologjike dhe të kërkimit.
- Edhe infrastruktura e komunikimit dhe informimit për kërkim është totalisht e papërshtatshme. Mjafton të përmendim se universitetet publike ende nuk kane akses në rrjete dhe biblioteka të fjalës së fundit të kërkimit shkencor në nivel ndërkombëtar.
- Kjo e kombinuar me kapacitetet e kufizuara për menaxhimin dhe zbatimin e kërkimit bazë dhe atij të aplikuar, në tërësi, e ka lënë komunitetin e kërkuesve shqiptarë të pa-integruar në rajon dhe më gjerë.
- Këto mungesa rezultojnë jo vetëm në produkte të dobëta kërkimore, por edhe në potenciale të kufizuara për të mësuar dhe nxënë mbi kërkimin në Shqipëri.

formimin universitar në të tre nivelet e tij (maturë, master, doktoraturë) si dhe (ii) përqendrimi i burimeve të nevojshme dhe sigurimi i një mbështetjeje sistematike për Inovacionin dhe transferimin e teknologjisë, për t'iu përgjigjur nevojave të sektorit

25. [http://www.arsimi.gov.al/files/userfiles/reformaalksh/Raport\\_Final\\_Ministria\\_Arsimit.pdf](http://www.arsimi.gov.al/files/userfiles/reformaalksh/Raport_Final_Ministria_Arsimit.pdf)

prodhues, duke u përqendruar në një numër të vogël fushash prioritare në 2015” (f. 16).

Edhe pse më shumë se gjysma e rrugës, në terma kohore, është bërë drejt arritjes së objektivave të vendosura nga strategjia kombëtare, raportet vlerësuese për Shqipërinë tregojnë për përpërim të kufizuara. Kërkimi dhe Inovacioni kanë marrë një vëmendje të vogël në terma buxhetorë. Sipas UNESCO shpenzimet e Shqipërisë për K&ZH ishin vetëm 0.15% në vitin 2008. Strategjia 2009-2015 parashikoi një trefishim të buxhetit me synim që ai të ngrihej në vlerën 0.6% të PPB. Edhe nëse ky objektivi do të arrihej deri në vitin 2015, Shqipëria do të ishte ende shumë larg nivelit 1.9% të mesatares së BE-së.<sup>26</sup>

### ***Sektori privat, lidhja industri-shkencë***

- Investimet e sektorit privat në shkencë dhe teknologji janë jashtëzakonisht të ulëta në Shqipëri.
- Bashkëpunimi midis industrisë dhe universiteteve është nga më të ulët në rang botëror duke e renditur Shqipërinë të 139-tën nga 144 shtete (për vitin 2012).
- Në Shqipëri ka vetëm 750 kompani të mesme dhe të mëdha, shumica e të cilave janë të përqendruara në aktivitete me teknologji të ulët, me stafe të vogla dhe strategji kryesore mbijetese – uljen e kostove të prodhimit.
- Sektori privat vuan edhe mungesën e kapitalit human. Vetëm një në pesë kompani i trajnojnë punonjësit në Shqipëri, kundrejt 35% të atyre në Evropë dhe Azinë Qendrore.

Sigurisht që fondet e kufizuara përbëjnë një faktor shtrëngues, por reformat mund të vazhdojnë edhe në një mjedis me burime financiare të kufizuara, nëse kuptohet dhe punohet për një përqasje sistematike (f. 19).<sup>27</sup> Kjo nuk duket të jetë zhvilluar mirë në Shqipëri duke iu referuar veçanërisht infrastrukturës ende të dobët, produkteve të dobëta të kërkimit dhe inovacionit, si dhe mungesës së angazhimit të sektorit privat. Ndonëse për të parat ekzistojnë hapa të hedhur përpara, në raport me përfshirjen e sektorit privat është vështirë të identifikohet ndonjë i tillë. Si rezultat, situata është ajo e paraqitur në kutinë 3. Objektivat e Strategjisë BE 2020 kërkojnë një kombinim të tri dimensioneve: reformim, investim dhe transformim të sistemit të kërkim - zhvillimit.<sup>28</sup>

26. World Bank, 2013 Western Balkans Regional R&D Strategy for Innovation, Country Paper Series, ALBANIA

27. ibid.

28. Europe 2020 Flagship Initiative Innovation Union, European Commission, Brussels, 6.10.2010 COM(2010) 546 final

Një prej çështjeve thelbësore është që investimi duhet të fokusohet në kërkim shkencor dhe Inovacion **par-ekselencë**, i aftë për të transformuar idetë novatore në zhvillime teknologjike në ndihmë të industrisë dhe të shoqërisë në përgjithësi. duke qenë se nuk ka një model ideal për strukturimin e sistemit të Kërkimit dhe Inovacionit. Sistemi duhet t'i përshtatet kërkesave dhe nevojave të mjedisit industrial, social dhe kulturor, në nivel kombëtar. Megjithatë, disa karakteristika dhe parametra të njëjta mund të adaptohen në vende me karakteristika të ngjashme.

### III. REFORMIMI I SISTEMIT PËR TË RRRITUR EFIKASITETIN E KËRKIMIT DHE INOVACIONIT / BASHKËPUNIMI ME SEKTORIN PRIVAT

Valorizimi i rezultateve të Kërkimit është jetike për të nxitur Inovacionin dhe për të rritur Konkurrueshmërinë. Është tashmë gjerësisht e pranuar se Kërkimi dhe Inovacioni janë motorët e zhvillimit dhe rritjes ekonomike. Mjaft e suksesshme rezultojnë edhe marrëdhënia midis kërkimit dhe rritjes që nxitet kryesisht nga kërkimi në sektorin privat. Logjika pas gjithë kësaj qëndron në faktin se kërkimi në sektorin publik është kryesisht i fokusuar në kërkime të thelluara bazë, duke qëndruar një hap larg tregut dhe duke pasur një influencë të ulët në krahasim me kërkimin që aplikohet në sektorin privat. Përkushtimi kryesor është që aktiviteti i kërkimit të jetë efektivisht i orientuar kah nevojave dhe kërkesave specifike të sektorit të biznesit dhe industrisë.

Vendet anëtare të BE, por edhe vendet e asociuara kanë ndërmarrë politika të ndryshme për t'iu përgjigjur nevojave të vendeve në kuadër të bashkëpunimit midis inovacionit dhe reformave të sipërmarrjes, mjedisit të biznesit dhe tregut të punës. Disa prej këtyre shteteve kanë parashtruar kushte të reja për punësimin e kërkuesve nga industria dhe për komercializimin e gjetjeve të tyre shkencore dhe teknologjike. Eficienca e produkteve shkencore po promovohet duke krijuar një balancë ndërmjet financimit institucional bazuar mbi projekte dhe financimit konkurrues. Financim institucional i bazuar mbi performancën lidhet ngushtësisht me kërkimin shkencor të shkëlqyer, ndërkombëtarizimin dhe bashkëpunimin me biznesin mbi shkencën dhe teknologjinë. Në vendet ku ka një industri të zhvilluar, është sektori privat i cili udhëheq dialogun për vendosjen e prioritetëve të kërkimit, në të kundërt (dhe kjo ndodh në pjesën më të madhe të vendeve të BE) është qeveria apo institucionet kombëtare kërkimore.

Për sa i takon Shqipërisë, hartimi i një sistemi të qëndrueshëm të instrumenteve dhe masave të ndërmarrja në sektorin publik, me qëllim nxitjen e investimeve në kërkim, zhvillim dhe inovacion si dhe për të rritur eficientësinë e këtyre investimeve kërkon një analizë dhe identifikim të marrëdhënieve (lidhjeve shkak-pasojë) midis faktorëve që ndikojnë në sistemin shqiptar. Për të arritur këtë është shumë e rëndësishme të kuptohen dinamikat e marrëdhënieve zëvendësuese apo plotësuese të kontributit publik dhe privat në K&ZH dhe Inovacion. Kjo bëhet gjithnjë dhe më koherente në një kontekst të tillë si Shqipëria ku investimet private në K&ZH janë të pakta, pothuajse inekzistente. Sektori publik, duhet të nxisë dhe mbështesë, dhe jo të zëvendësojë investimet private.


Dokumentet strategjike dhe politikat kombëtare parashikojnë masa nxitëse dhe lehtësuese në lidhje me zhvillimin e Kërkimit dhe Inovacionit dhe transferimit të teknologjive. Por impakti i tyre është i papërfillshëm. Nga ana tjetër, interesi i sektorit privat duhet të simulohet nëpërmjet lehtësimit të aksesit të rezultateve të kërkimit dhe aktiviteteve të inovacionit, që mund të shërbejnë si baza e thellimit të Inovacionit të ndërmarrë nga sektori privat.

Ndërhyrja politike për të intensifikuar rrjedhën e njohurisë dhe teknologjisë duhet të shoqërohet me iniciativa serioze, për sa u tha më sipër si dhe mbi të gjitha mbi cilësinë e burimeve njerëzore të punësuar në sistemin e kërkimit. Përveç disa masave politike të orientuara kah përmirësimin të burimeve dhe rezultateve (masa të ndërmarrë këto edhe në Strategjitë Kombëtare), shfrytëzimi i rezultateve të projekteve K&ZH të financuara nga programet kombëtare është shumë i ulët, për arsye të nivelit të ulët të dobishmërisë së rezultateve të tyre, infrastrukturës së varfër në transferimin e teknologjive, lidhjes së ulët me sektorin e biznesit, dhe si pasojë e mungesës së vlerësimit ex-post dhe monitorimit të rezultateve të kërkimit.



Nga ana tjetër, është shumë e rëndësishme të theksohet se shfrytëzimi i rezultateve kërkimore të fituara në universitetet dhe institutet kërkimore publike varet edhe nga kapacitetet adekuate absorbuese, e të përdoruesve potencialë të kompanive si dhe aftësia e tyre për të vlerësuar, asimiluar dhe përdorur njohuritë e vëna në dispozicion në mjedisin e jashtëm. Edhe pse është në interesin e sektorit privat të investojë në këtë drejtim, duke përthithur ekspertë të aftë për të vënë në jetë rezultatet e dalë nga rezultatet e Shkencës dhe Inovacionit, krijimi i një mjedisi të favorshëm për bashkëpunimin midis institucioneve kërkimore dhe sektorit privat mbetet thelbësor. Për më tepër, qasja ndaj vendosjes së prioriteteve kërkimore shkencore dhe të inovacionit duhet të përmirësohet ndjeshëm. Vendosja e këtyre prioriteteve është bërë në një qasje unilaterale, ku ka munguar dialogu dhe bashkërendimi me sektorin privat. Një balancë e mirë-studiuar midis kërkimit bazë dhe atij të zbatuar do të rrisë impaktin e rezultateve të kërkimit në ekonomi. Alokimi i burimeve mund të orientohet nga një "strategji për specializim të zgjuar", e cila favorizon fushat ku ekselencën e kërkimit shkencor i vjen në ndihmë potencialit të zhvillimit ekonomik të vendit.

Së fundmi, vendosja e stimujve fiskalë dhe modernizimi i sistemit të patentimit, janë dy nga çështjet që duhet të merren në konsideratë me prioritet. Stimujt fiskale janë një mekanizëm i rëndësishëm për nxitjen e aktivitetit K&ZH në sektorin privat. Përveç kreative standarde për investime në K&ZH, masa të tjera si stimuj për të mbështetur "spin-off", "spin-out" apo fillimin e parqeve dhe klasterave teknologjike duhet të merren në konsideratë. Në të njëjtën linjë, modernizimi i sistemit kombëtar për patentimin, është gjithashtu një nga çështjet që duhet të merren në shqyrtim për të mbrojtur të drejtat e shpikësve dhe për të mbështetur më mirë shfrytëzimin e rezultateve të kërkimit nga ndërmarrjet, universitetet dhe qendrat kërkimore.

#### IV. AFËR DHE LARG: ECURIA E VENDEVE TË RAJONIT NË SEKTORIN E K&ZH SLOVENIA DHE SERBIA



Gjatë dekadës së fundit **Slovenia** ka rritur në mënyrë të ndjeshme intensitetin e K&ZH, duke pësuar një rritje prej 1.38% në 2002 në 2.47% në vitin 2011, një vlerë e cila është më e lartë se mesatarja e BE prej 2.3%. Në dokumentin "Slovenia 2011-2020" janë ndërmarrë disa masa për të adresuar problemet e K&ZH si dhe për të ndërmarrë disa masa në nivel politikash. Qendrat e kërkimit udhëhiqen nga sektori privat (biznese), duke bërë të mundur kombinimin e kërkimit bazë me kërkimin e aplikuar me synimin për të krijuar mundësi tregu në të ardhmen dhe duke plotësuar punën e Qendrave të Ekselencës. Këto të fundit, fokusohen kryesisht në kërkim bazë. Gjithashtu janë ngritur edhe Qendrat e Zhvillimit (të cilat janë konsortiume me kompanitë e biznesit, kërkimi i të cilave fokusohet më shumë në zhvillimin e produkteve, proceseve dhe shërbimeve të reja, me synimin për të qenë "më afër tregut". Ndërkohë, qeveria ka rritur fondet për të dhënien e kredive dhe garancive për K&I si dhe për dhënien e kredive, nëpërmjet Fondit për Ndërmarrjet Slovene dhe nëpërmjet Bankës Slovene për Zhvillim dhe Eksport, duke evituar kështu dhënien e subvencioneve direkte sektorit privat apo bizneseve.



**Serbia** gjithashtu i ka kushtuar një vëmendje të veçantë nxitjes së bashkëpunimit midis akademisë dhe sektorit privat. Për gjatë periudhës 2003-2010, bashkëpunimet midis universiteteve dhe sektorit privat shënuan 22.13% të të gjithë bashkëpunimeve, një shifër mjaft e lartë kjo e krahasuar me (0.02% në vendet e Ballkanit Perëndimor) dhe 1.38% në vendet anëtare të BE-së . Për më tepër, me aprovimin e Ligjit të Inovacionit 2010, Serbia ka bërë hapa domethënës në planifikimin strategjik dhe masave që do të ndërmarrë në kuadër të transferimit teknologjik dhe Inovacionit. Ligji lejon krijimin e organizatave që mbështesin aktivitetet novatore dhe transferimin e teknologjisë, i jep të drejta krijuesve për të marrë përfitime konkrete nga shpikjet e tyre. Në bazë të këtij ligji, të drejtat e pronësisë intelektuale që rrjedhin nga kërkime të financuar publikisht i përkasin organizatës ku janë krijuar këto të drejta intelektuale. Gjithashtu, ky ligj parashikon që shpikësit të kompensohen me të paktën 50 për qind të fitimeve që rrjedhin nga shfrytëzimi i patentave. Në vendet e tjera të rajonit, nuk ka asnjë bazë ligjore që përcakton pronësinë dhe komercializimit e punës kërkimore të gjeneruar në institucione kërkimore.



## V. RITJIA E PERFORMANCËS SË KËRKIMIT

Strategjia e BE 2020 ka përcaktuar një set masash si udhërrëfyese për vendet anëtare apo ato të asociuara, të cilat synojnë rritjen e performancës së kërkimit si dhe unifikimin dhe forcimin e Zonës Evropiane të Kërkimit (zonë ku të gjithë aktorët, publikë apo privatë mund të bashkëpunojnë lirshëm, duke krijuar kështu një masë kritike konkurruese në nivel global). Bazuar në kontekstin e paraqitur më sipër, të gjitha masat e propozuara nga kjo Strategji dhe të zbatuara nga vendet e BE-së dhe të rajonit të Ballkanit janë relevante edhe për Shqipërinë. Bazuar në orientimet që vijnë nga BE 2020 si dhe nga përvojat e vendeve të tjera të cilat kanë rezultuar të suksesshme në zhvillimin e sektorit të Kërkimit dhe Inovacionit, **është e rëndësishme që Shqipëria të ndërmarrë një sërë masash të detajuara si më poshtë:**

» Së pari, është jetike të ndërtohet një **“gjendje” punonjësish të mirë-kualifikuar** (eng. stock of knowledge workers), veçanërisht kërkues. Për këtë, Shqipëria duhet të hartojë një numër programesh të cilat kanë për qëllim tërheqjen e të rinjve për të vazhduar studimet e doktoraturës.<sup>29</sup> Masat e parashikuara në Plan Veprimin e STI 2009-2015 në kuadër të “Programit të Granteve të Shqipeve për Kërkim”, mbeten sipërfaqësore dhe njëanshmërisht të fokusuara drejt mbështetjes financiare për tërheqjen e kërkuesve të rinj. Në mungesë të fondeve, i parashikuar që prej 2009, ky program mbetet akoma në letër.

» Së dyti, është shumë e rëndësishme **ritja e përfshirjes së grave si kërkuese** në institucionet kërkimore shqiptare. Edhe pse pjesëmarrja e vajzave dhe grave në nivelet e avancuara studimore (Master dhe Doktoraturë) në Shqipëri i tejkalon ato të burrave, trendi nuk është reflektuar në hierarkinë vendimmarrëse dhe politikë-bërëse në fushën e Kërkimit dhe Inovacionit.<sup>30</sup> Si edhe vendet e BE-së dhe të rajonit, edhe Shqipëria duhet të hartojë masa për të adresuar mungesën e ekuilibrit gjinor në kërkimin shkencor në vendimmarrje dhe në veçanti për të mbështetur gratë në aspiratat e tyre në karrierën si kërkuese. Këto masa duhet të synojnë: 1) përmirësimin e aksesit të femrave, kërkuese të reja në programet dhe fondet e kërkimit; 2) ndërmarrjen e aktiviteteve dhe vendosjen e instrumenteve për të lehtësuar aksesin e grave në pozitat të nivelit të lartë (në borde drejtuese në sektorin e arsimit të lartë dhe të institucioneve kërkimore shkencore); 3) nxitjen e diskutimeve rreth temës së balancës gjinore dhe sigurimi i mbështetjes së vendimmarrëseve për parimin e balancës gjinore në fushën e kërkimeve.<sup>31</sup>

» Së treti, vendosja e **procedurave të rekrutimit të hapura, transparente dhe të bazuara në meritokraci**, janë parakusht për përmbushjen e objektivave të Zonës Evropiane të Kërkimit. Ky hap është i domosdoshëm për të arritur një performancë të lartë akademike dhe për të përmirësuar rezultatet e kërkimit shkencor.

29. Aktualisht nuk ka asnjë incentivë për nxitjen e studentëve ekselentë që zgjedhin të kryejnë studimet doktorale në Shqipëri, por mbështeten me fondin e ekselencës vetëm ata që fitojnë të drejte studimi në vende perëndimore.

30. Kalaja, D. “Përfaqje të krahasuara gjinore në hapësirën midis regjistrimeve dhe diplomimeve në Shqipëri, Universiteti i Tiranës, Tirana.”

31. Këto masa mund të përfshijnë ligjet kombëtare, planet e veprimit, ngritjen e komiteteve dhe grupeve të punës me qëllim reduktimin e pabarazisë gjinore në profesionin kërkimor. Për shembull, Ministria Sllovene e Arsimit të Lartë, Shkencës dhe Teknologjisë në vitin 2001 krijoi një Komitet Kombëtar për Gratë në Shkencë.

» Së katërti, **ofrimi i kushteve të mira për punë dhe perspektiva për zhvillimin e një karriere si kërkues** (si një profesion më vete), janë nxitësit kryesorë për të tërhequr të rinj në këtë profesion si dhe për të tërhequr kërkues të një cilësie të lartë pranë institucioneve kërkimore publike. Kjo kërkon adresimin e sfidave aktuale për ata të cilët futen në këtë sistem si kontratat afat-shkurtra, mos-përfitimi nga sigurimet shoqërore/ shëndetësore apo përfitime të tjera si, lejet e lindjes etj. Punëdhënësit (universitetet, institucionet kërkimore, agjencitë e financimit si dhe të sektorit privat) duhet të sigurojnë, që kërkuesit në të gjitha fazat e karrierës së tyre, të gëzojnë kushte të drejta adekuate në përputhje me legjislacionin ekzistues kombëtar mbi punësimin.<sup>32</sup>

» Së pesti, duhet të investohet gjerësisht në **nxitjen e lëvizshmërisë së kërkuesve** dhe aktivizimin e tyre në nivel ndërkombëtar. Lëvizshmëria është një koncept thelbësor i Zonës Evropiane të Kërkimit. Kjo nga ana tjetër është themelore për rritjen e BE-së dhe në Strategjinë dhe Vizionin për 2020, i cili synon të përmirësojë dinamizmin dhe konkurrencën e ekonomisë të BE-së. Lëvizshmëria është e lidhur shpesh me përsosmërinë, krijimin e rrjeteve dinamike, përmirësimin e performancës shkencore, të njohurive dhe të transferimit të teknologjisë, rritjen e produktivitetit dhe së fundmi rritjen e ekonomisë dhe të mirëqenies sociale.<sup>33</sup> EURAXESS është një mjet kyç në mbështetjen e lëvizshmërisë së kërkuesve. Shqipëria është i vetmi vend në Evropë dhe Ballkanin Perëndimor që nuk ka një faqe me profil kombëtar në portalin Evropian të EURAXESS.

» Së gjashti, **hartimi dhe zbatimi i "Kartës dhe Kodit"** nga të gjitha institucionet që rekrutojnë kërkues si një strategji për zhvillimin e burimeve njerëzore dhe ekselencës së institucioneve në kërkim. Rekomandimet e parashikuara në Kartën Evropiane për Studiuësit dhe Kodit të Sjelljes për Rekrutimin e Kërkuesve<sup>34</sup> parashikon rolet, përgjegjësitë dhe të drejtat e kërkuesve, si dhe të punëdhënësve dhe donatorëve të tyre. Qëllimi i Kartës është të sigurojë që natyra e marrëdhënies midis kërkuesve dhe punëdhënësve apo donatorëve është e favorshme për kryerjen e suksesshme në gjenerimin, transferimin, ndarjen dhe shpërndarjen e njohurive dhe zhvillimin teknologjik si dhe për zhvillimin e karrierës së kërkuesve.

Në dokumentin përfundimtar për reformimin e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor në Shqipëri, hartuar gjatë vitit 2014, adresohen një pjesë e rëndësishme e elementeve që ndikojnë në sa u listua më sipër. Megjithatë, mbetet ende për t'u parë përkthimi i tyre në masa konkrete dhe zbatueshmëria e tyre. Gjithashtu, në formën aktuale të dokumentit ka pak (ose aspak) specifikime për sa i takon rritjes së incentivave për të tërhequr dhe mbajtur pranë universiteteve dhe kërkimit shkencor kapacitetet më të mira, për të nxitur dhe promovuar pjesëmarrje më të madhe të vajzave dhe grave në kërkimin shkencor dhe në të gjitha nivelet e akademike, përmirësimin e kushteve të punës për kërkuesit dhe akademikët si dhe mundësimin e lëvizshmërisë së kërkuesve dhe akademikëve në nivel rajonal e ndërkombëtar.

32. Ministrat e BE përgjegjës për hulumtim (Këshilli për Konkurrencë ) u takuan më 2 mars 2010 për të diskutuar mbi angazhimin e kërkuesve evropianë dhe zhvillimin e karrierës së tyre. Në konkluzionet e tyre , ata i ftuan Shtetet Anëtare në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar , "për të siguruar mbulimin e duhur të sigurimeve shoqërore për të gjithë studiuesve , duke përfshirë edhe kandidatët e doktoraturës , të cilët janë të angazhuar në aktivitet kërkimore me pagesë"

33. Europe 2020 Flagship Initiative Innovation Union, European Commission, Brussels, 6.10.2010 COM(2010) 546 final

34. Charter and Code for Researchers: <http://ec.europa.eu/euraxess/index.cfm/rights/europeanCharter>

## VI. PËRFUNDIME

Rritja dhe forcimi i kapaciteteve të Kërkimit dhe Inovacionit është një hap më afër integritit në BE, në dy aspekte kryesore: së pari në përmbushjen e kërkesave të Kapitullit 25 të *acquis communautaire* të BE për Shkencën dhe Kërkimin si dhe pjesëmarrjen në programet e BE për K&ZH dhe së dyti, në krijimin e një ekonomie që mund t'i bëjë ballë sfidave të ekonomisë në tregun e BE-së. Nga pikëpamja e strategjisë së BE 2020, vendet të cilat do të jenë në gjendje të hartojnë strategjitë kombëtare duke iu përgjigjur objektivave të BE, do të kualifikohen edhe për fondet IPA, kjo e vlefshme edhe për politikat e Kërkimit dhe Inovacionit. Kërkimi shkencor dhe Inovacioni kanë marrë një vëmendje kyçe në Strategjinë e Bashkimit Evropian për vitin 2020. Prioritetet e vendosura për vendet anëtare janë njëlloj të vlefshme edhe për Shqipërinë që gjithashtu duhet të tregohet njëlloj e përgatitur për thithjen e tyre.

Me marrjen e Statusit Kandidat, ky vend është tashmë në një rrugë të pakthyeshme drejt Integritit Evropian. Shqipëria është e angazhuar në rritjen e investimeve dhe në krijimin e një mjedisi lehtësues për zhvillimin e kërkimit shkencor dhe teknologjisë në vend, që prej vitit 2009. Megjithatë, edhe sot pas 4 viteve, ky sektor qëndron në një stagnacion zhvillimor, ku pak është bërë për të përmbushur angazhimet dhe për të arritur objektivat e ndërmarra. Ky dokument politikash, u përpoq të nënvijëzonte problematikat kryesore të sektorit si dhe të theksonte një sërë rekomandimesh mbi hapat që duhen ndërmarrë nga sektori publik dhe ai privat për të bërë që Shqipëria të jetë një aktor dhe faktor në nivel rajonal në fushën e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit.

Pavarësisht zhvillimeve të viteve të fundit dhe vullnetit për reformime në këtë sektor, udhëzimet e listuara në këtë dokument për rritjen e performancës së kërkimit shkencor në vend mbeten jo vetëm relevante, por të domosdoshme. Vëmendje e posaçme duhet të shkojë veçanërisht për sa i takon:

- rritjes së incentivave për të tërhequr dhe mbajtur pranë universiteteve dhe kërkimit shkencor kapacitetet më të mira;
- për të nxitur dhe promovuar pjesëmarrje më të madhe të vajzave dhe grave në kërkimin shkencor dhe në të gjitha nivelet e akademike;
- për përmirësimin e kushteve të punës për kërkuesit dhe akademikët si dhe mundësimin e lëvizshmërisë së kërkuesve dhe akademikëve në nivel rajonal e ndërkombëtar.

Gjithashtu, lipset të fitohet koha e humbur për tërheqjen dhe angazhimin e vazhdueshëm të sektorit privat në fushën e kërkimit dhe inovacionit. Njohja dhe harmonizimi i nevojave, kërkesave dhe burimeve të sektorit privat me ato të akademisë, kërkimit dhe inovacionit në vend janë hapat e parë, të domosdoshëm, për ndërtimin e një raporti të qëndrueshëm dhe funksional sektor privat – kërkim, zhvillim dhe inovacion.

## VII. BIBLIOGRAFI

Bosch, M., Lederman, D., dhe Maloney W.F., (2005) Patenting and Research and Development: A Global View, World Bank [http://www.crei.cat/conferences/RandD\\_and\\_Innovation\\_in\\_the\\_Development\\_Process/activities/sc\\_conferences/23/papers/maloney.pdf](http://www.crei.cat/conferences/RandD_and_Innovation_in_the_Development_Process/activities/sc_conferences/23/papers/maloney.pdf)

COM (2010) Europe 2020 Flagship Initiative Innovation Union, European Commission, Brussels, 6.10.2010 COM (2010) 546 final

EURAXESS, Charter and Code for Researchers, <http://ec.EUROPA.eu/euraxess/index.cfm/rights/europeanCharter>

Griliches, Z. (1979) Issues in assessing the contribution of research and development to productivity growth. *Bell Journal of Economics* 10 (I), 92-116, 1979.

Harrison, R., Jaumandreu, J., Mairesse, J., dhe Peters, B. (2008). "Does Innovation Stimulate Employment? A Firm-Level Analysis Using Comparable Micro-Data From Four European Countries," NBER WORKING PAPER SERIES <http://eprints.ucl.ac.uk/18867/1/18867.pdf>

Kalaja, D. (2013) "Përfaqje të krahasuara gjinore në hapësirën midis regjistrimeve dhe diplomimeve në Shqipëri", Universiteti i Tiranës, Tirana. <http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2013/12/Doktoratura-Daniela-Kalaja-Fakulteti-i-Shkencave-Sociale-Departamenti-Pune-Sociale.pdf>

Lederman, D. dhe Maloney, W.F., (2002). "Trade Structure and Growth." Mimeographed. Office of the Chief Economist for LCR, The World Bank, Washington, DC.

Lederman, D., dhe Saenz, L.(2003). "Innovation around the World: A Cross-Country Data Base of Innovation Indicators." Mimeographed. Office of the Chief Economist for LCR, The World Bank, Washington, DC.

MAS (2014) "Raporti përfundimtar për reformen në arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor 2014" [http://www.arsimi.gov.al/files/userfiles/reformaalksh/Raport\\_Final\\_Ministria\\_Arsimit.pdf](http://www.arsimi.gov.al/files/userfiles/reformaalksh/Raport_Final_Ministria_Arsimit.pdf)

World Bank (2013) Western Balkan Regional R&D Strategy for Innovation, October, 2013

World Bank (2013) Western Balkans Regional R&D Strategy for Innovation, Country Paper Series, ALBANIA.

